



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 510/2019

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.08.2019, shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruktion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj në procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF- 19520-04-24-2019, me objekt: “*Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7*”, me fond limit 2.332.573.946 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Ircop” S.p.a. & “Sulova Ndërtim Prodhim” & “Vega” & “A&E Engineering” në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruktion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj
Rruga “Dora D’Istria”, Hyrja nr. 6, Tiranë

Autoriteti Kontraktor: Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, nr. 33, Tiranë

Subjekt i interesuar: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ircop” S.p.a. & “Sulova Ndërtim Prodhim” & “Vega” & “A&E Engineering”
Përfaqësuar nga shoqëria “Sulova Ndërtim Prodhim” sh.p.k.
Pranë Hotel “Skampa”, Kati I, Elbasan

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 25.04.2019 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19520-04-24-2019, me objekt: “*Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7*”, me fond limit 2.332.573.946 lekë (pa TVSH).

II.2. Në datën 17.06.2019, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor, në këtë procedurë prokurimi, kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH) përkatësisht:

1. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a.
& “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k.
& “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj 1.789.598.000 lekë, skualifikuar
2. “Pe – Vla - Ku” sh.p.k. 1.889.384.779lekë, skualifikuar
3. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Fusha” sh.p.k.
& “Aydiner Inssat Anonim Sikerti” & “Gjeokonsult
& Co” sh.p.k. 1.959.595.959 lekë, skualifikuar
4. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gener 2” sh.p.k.
& “Seedc Consulting” & “Infra Konsult” 2.077.280.578,13 lekë, skualifikuar
5. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Alb Building” sh.p.k.
& “Be-Is” sh.p.k. & “F&S” & “C.E.C. Group”
& “Nord – Comat” 2.295.400.000 lekë, skualifikuar
6. Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Ircop” S.p.a.
& “Sulova Ndërtim Prodhim” & “Vega”
& “A&E Engineering” 2.299.327.253,75 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 20.06.2019 operatori ekonomik ankimues është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me arsyet si më poshtë vijon:

2 Bashkimi i operateve GJOKA sha & Cobial shpk & GR Albania shpk & Geo Portal dege e shoqerise se huaj , rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kriterave per kualifikim dhe kerkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT

2.3 Oferta e paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomik duhet te skualifikohet bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohe të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Operatoret Gjoka Konstruksion sha & Cobial shpk , pjese e ketij bashkimi me 98.5 % (Gjoka 73.5 % dhe 25 & Cobial) te puneve te marra perisper, rezultojne te jene po se bashku si kontraktore me ARRSH-ne, per kontraten me objekt Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4, si bashkim i

perkohshem i operatoreve ekonomik Cobial shpk & Gjoka konstruksion sha, per te cilen nuk jane perfunduar 70 % e punimeve te kontraktuara.

Kete fakt e kane pranuar edhe vete operatori duke e deklaruar ne shtojca 11 si pune ne process pikerisht kontraten e siperpermendur.

Mosperfundimi I 70 % punimeve eshte shkak skualifikimi jo vetem I parashikuar ne VKM 42/2008 por edhe praktike e vendimarrjes se ARRSHse edhe ne procedura tjera te mepareshme prokurimi. Skualifikimi per kete arsye ne kete procedure prokurimi eshte nje fakt I njohur per operatoret sepse AK , ne pergjigje te nje kerkese per sqarim ka botuar ne [ëëë.app.gov. al](http://ëëë.app.gov.al) pergjigjen se mosperfundimi I 70 % te fondit te prokuruar ne kontrata aktuale me ARRSH do te ishte arsye per skualifikim per cdo operator qe do te rezultonte me kete problematike.

2.4 Kapacitetet teknike, profesionale e njerezore te deklaruar nga BO Gjoka & Cobial shpk , rezultojne te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontraten qe ky operator ka ne proces zbatimi, cka vjen ne kundërshtim dhe deshmon mosplotesim te pikes 2.3.7/a te kriterëve te vecanta per kualifikim

2.5 Operatori duhet te skualifikohet ne zbatim te percaktimeve te nenit 45 te LPP sepse nje nga pjesetaret e ketij bashkimi operatorsh , konkretisht operatori Gjoka sha , ka te papaguara detyrime te kontributeve te sigurimeve shoqerore qe sipas ligjot punedhenesi paguan per punemarërsit e tij .

Gjoka sha ka paraqitur vertetimin T 01083283 dt 20.05.2019 te leshuar nga Drejtoria tatimore ku deshoher se ka te papaguara detyrime te contribute te sigurimeve shoqerore.

Po keshtu edhe nje nga pjesetarte e tjere te ketij bashkimi , Gjeo portal dege e shoqerise se huaj ka detyrime te papaguara. Geoportal dege e shoqerise se huaj ka paraqitur vertetimin nr T 01154361 dt 13.06.2019 te leshuar nga drejtoria tatimore ku konfirmohet se ka te papaguara detyrime te contribute ve te sigurimeve shoqerore

Per sa me siper , mbeshtetur ;

Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.”.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”..

Per sa me siper, Oferta e BO GJOKA sha & Cobial shpk & GR Albania shpk & Geo Portal dege e shoqerise se huaj , skualifikohet.

II.4. Në datën 26.06.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, ku kundërshton skualifikimin e ofertës së tij.

Konkretisht operatori ekonomik ankimues pretendon se:

Autoriteti Rrugor Shqiptar në rolin e autoritetit kontraktor ka publikuar në datën 25.04.2019 në ëëbsite e Agjencisë së Prokurimit Publik, njoftim për procedurën e prokurimit me objekt “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7” me numër REF – 19520-04-24-2019, tender i njoftuar për t’u zhvilluar me datë 17.06.2019, ora 11:00.

Pasi është bërë publikimi i prokurimit të njoftuar nga Autoriteti Rrugor Shqiptar nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik (SPE) në faqen zyrtare ëëë.app.gov.al bashkimi i operatorëve ekonomikë shoqëritë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & JV “Gr Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj.

Ak në sistem ka njoftuar pjesëmarrjen dhe renditjen e operatorëve ekonomikë ofertues:

Operatorët ekonomikë	Vlerat e ofertuara	Refuzuar	Arsyet
Gjoka Konstruksion	1.789.598.000	Po	[...]
Pe – Vla - Ku	1.889.384.779	Po	[...]
Fusha	1.959.595.959	Po	[...]
Gener 2	2.077.280.578,13	Po	[...]
Alb Building	2.295.400.000	Po	[...]
Ircop” S.p.a.	Ircop” S.p.a.	Jo	[...]

Arsyet që KVO ka dhënë për s’kualifikimin e kryer janë:

2 Bashkimi i operatoreve GJOKA sha & Cobial shpk & GR Albania shpk & Geo Portal dege e shoqërisë së huaj , rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithë kritereve per kualifikim dhe kerkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT

2.3 Oferta e paraqitur nga ky bashkim operatoresh ekonomik duhet te skualifikohet bazuar ne Vendimin e Keshillit te Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku thuhet “Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Operatoret Gjoka Konstruksion sha & Cobial shpk , pjese e ketij bashkimi me 98.5 % (Gjoka 73.5 % dhe 25 & Cobial) te puneve te marra perisper, rezultojne te jene po se bashku si kontraktore me ARRSH-ne, per kontraten me objekt Ndertim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4, si bashkim i perkohshem i operatoreve ekonomik Cobial shpk & Gjoka konstruksion sha, per te cilen nuk jane perfunduar 70 % e punimeve te kontraktuara.

Kete fakt e kane pranuar edhe vete operatori duke e deklaruar ne shtojca 11 si pune ne process pikerisht kontraten e siperpermendur.

Mosperfundimi I 70 % punimeve eshte shkak skualifikimi jo vetem I parashikuar ne VKM 42/2008 por edhe praktike e vendimarrjes se ARRSHse edhe ne procedura tjera te mepareshme prokurimi. Skualifikimi per kete arsye ne kete procedure prokurimi eshte nje fakt I njohur per operatoret sepse AK , ne pergjigje te nje kerkese per sqarim ka botuar ne [ëëë.app.gov. al](http://ëëë.app.gov.al) pergjigjen se mosperfundimi I 70 % te fondit te prokuruar ne kontrata aktuale me ARRSH do te ishte arsye per skualifikim per cdo operator qe do te rezultonte me kete problematike.

2.4 Kapacitetet teknike, profesionale e njerezore te deklaruar nga BO Gjoka & Cobial shpk , rezultojne te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontraten qe ky operator ka ne proces zbatimi , cka vjen ne kundërshtim dhe deshmohet mosplotesim te pikes 2.3.7/a te kriterave te vecanta per kualifikim

2.5 Operatori duhet te skualifikohet ne zbatim te percaktimeve te nenit 45 te LPP sepse nje nga pjesetaret e ketij bashkimi operatorsh , konkretisht operatori Gjoka sha , ka te papaguara detyrime te kontributeve te sigurimeve shoqerore qe sipas ligjit punedhenesi paguan per punemarersit e tij .

Gjoka sha ka paraqitur vertetimin T 01083283 dt 20.05.2019 te leshuar nga Drejtoria tatimore ku deshohet se ka te papaguara detyrime te contribute te sigurimeve shoqerore.

Po keshtu edhe nje nga pjesetarte e tjere te ketij bashkimi , Gjeo portal dege e shoqerise se huaj ka detyrime te papaguara. Geoportal dege e shoqerise se huaj ka paraqitur vertetimin nr T 01154361 dt 13.06.2019 te leshuar nga drejtoria tatimore ku konfirmohet se ka te papaguara detyrime te contribute ve te sigurimeve shoqerore

Per sa me siper , mbeshtetur ;

Ne neni 74 pika 3 të VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave për prokurimin publik”, i ndryshuar, ku parashikohet se ; Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje. ”.

Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” ku parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”

Në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit”.

Per sa me siper, Oferta e BO GJOKA sha & Cobial shpk & GR Albania shpk & Geo Portal dege e shoqerise se huaj , skualifikohet.

Lidhur me arsyet e skualifikimit të paraqitura nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave parashtrojmë kundërshtimet tona.

1. Lidhur me pretendimin e parë sqarojmë se:

Autoriteti kontraktor sipas DST faqe 30 ka kërkuar vetëm plotësimin e Shtojcës 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces” nga operatorët ekonomikë. Kjo deklaratë sipas Shtojcës është plotësuar dhe dorëzuar nga anëtarët e BO “Gjoka Konstruksion” sha & “Cobial” shpk. AK nuk ka vendosur në asnjë rresht të DST si kriter kualifikimi që operatorët ekonomikë ti referohen VKM nr. 42, datë 16.01.2008, Kreu III, Pika 1, paragrafi II b, i ndryshuar, me qëllime të përgatitjes së deklaratës. Të dyja shoqëritë “Gjoka Konstruksion” sha & “Cobial” shpk pjesë e bashkimit të OE, në përputhje të plotë me sa kërkuar në Shtojcën 11 kanë paraqitur tabelën me kontratat e punëve të lidhura dhe në proces zbatimi, ku i vetmi kriter i vendosur nga AK është plotësimi i kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor /nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe / ose është shpallur fitues me vlerë të përbashkët ose të veçantë më të madhe se 100% i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Nr.	Autoriteti kontraktor	Objekti i procedurës së prokurimit/kontratës	Vlera e shpallur fituese

Referuar kësaj kërkesë të AK në DST njëkohësisht edhe kërkesë ligjore kjo, anëtarët e BO e plotësojnë këtë kërkesë, duke mos qenë brenda të njëjtës periudhë kontraktor /nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë më të madhe se 100% i kufirit maksimal që disponojnë sipas licencës profesionale. Referohuni lutem shënimit 4 të shtojcës 11 faqe 30 e DST.

Marrë në konsideratë arsyetimin e bërë nga KVO mbi VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b, citojmë “Subjektet e licencuara në zbatim nuk mund të kualifikohen si fituese për punë publike të prokuara sipas ligjit të prokurimit publik nëse janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktor /nënkontraktor një investim sipas një kontrate të lidhur /apo në proces për t’u lidhur sipas ligjit të prokurimit publik me vlerë të përbashkët ose të veçantë që tejkalon vlerën e kategorisë që mban subjekti sipas lidhjes 4. Subjektet e licencuara kanë të drejtë të marrin pjesë / apo të shpallen fituese në prokurime publike, brenda të njëjtës periudhë deri në vlerën e licencës së përcaktuar sipas lidhjes 4. Në kuptim të kësaj shkronje fjala “periudhë” kupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas ligjit të prokurimit publik nga momenti i shpalljes fitues deri në kolaudim të objektit /investimit.

Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoritetet kontraktore sipas ligjit të prokurimit publik hartojnë dokumentat standarte të tenderit dhe dokumentat e tenderit në përputhje me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara këtu me detyrimin që kur verifikohet se subjekti përfshihet në

investime që tejkalojnë klasën e kategorisë së licencuar sipas lidhjes 4, kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”, sqarojmë se argumenti i parashtruar se ndalohet Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve të kualifikojë si fitues për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë që janë fitues dhe/apo kanë në proces në të njëjtën kohë si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit të prokurimit publik i cili nuk ka përfunduar punimet në 70% të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve dhe se Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve përshtasin dokumentat standarte të tenderit dhe dokumentat e tenderit me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence, nuk ka qene vendosur në kriteret e kualifikimit në DST.

Argumentuar sa më sipër, në kushtet kur vetë Agjencia e Prokurimit Publik por as AK nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për përshtatjen e dokumentave standarte të tenderit me Rregulloren që pretendon si kriter kualifikimi të papërmbyshur nga BO në njoftimin e skualifikimit të bërë, VKM –së nr. 42 datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b të ndryshuar, por ka kërkuar plotësimin e Shtojcës 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces”, si të vetmin kriter kualifikimi të vendosur për plotësimin e kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda të njëjtës periudhë nuk është kontraktor /nënkontraktor për kontratë /kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë më të madhe se 100 % i kufirit maksimal që disponon sipas licencës profesionale të lëshuar nga autoriteti kompetent, i gjithë argumentimi i mësipërm nuk qëndron.

Në përputhje me nenin 53 të LPP “Shqyrtimi i ofertave”, pika 3, Autoriteti kontraktor vlerëson ofertën të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontrtës dhe në dokumentat e tenderit.

Në përputhje me nenin 53 të LPP pika 3, autoriteti kontraktor vlerëson ofertën të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Trajtimi i këtij kriteri duke deformuar vullnetin e shprehur dhe publikuar në DST nga autoriteti kontraktor, konkretisht Shtojcën 11 të DST, vjen njëkohësisht në kundërshtim me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, siç është VKM nr. 914 datë 29.12.2014, e ndryshuar, për të cilën sqarojmë se:

- Më 29.12.2014 në nenin 26 “Kontratat për punët publike”, pika 10 është vendosur për t’u përfshirë në DST kufizimi që Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohet të kualifikojë për punë publike të prokuruar sipas LPP-së operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim /investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhur a në proces për t’u lidhur sipas LPP, i cili në castin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.

Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ku secili prej tyre për t'u kualifikuar për punë publike duhet të ketë përfunduar punimet fizike në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit...

- *Pika 10 e nenit 26 është shfuqizuar me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 dhe është shtuar në pikën 8 gërma ç) kërkesa: “Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që nuk është fitues dhe/apo ka në proces në të njëjtën kohë si kontraktorë/nënkontraktorë një investim /investime sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur sipas LPP i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve ku secili prej tyre për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit. Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nënkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkaqe të përligjura, si vijon: i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si: KUZ, OSHEE etj.; ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike; iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve të cilave u përket prona; iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim; v) rishpërndarje e fondeve si pasojë e ndonjë emergjence të justifikuar nga autoriteti kontraktor, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit. Në çdo rast një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve, pjesë e kontratës deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës.*
- *Me VKM nr. 80, datë 14.02.2018 është shfuqizuar pika 8, gërma ç).*

Në përmbledhje të gjithë sa më sipër arsyetimi i dhënë nga KVO është plotësisht në kundërshtim me kërkesat dhe kriteret e veçanta të kualifikimit të vendosura nga autoriteti kontraktor në DST me ligjin “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij “VKM nr. 914, datë 29.12.2014”, e ndryshuar, por njëkohësisht theksojmë se:

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë ka përcaktuar se sipas neneve 116 dhe 118:

“Aktet normative që kanë fuqi në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë janë:

- a) Kushtetuta;*
- b) Marrëveshjet ndërkombëtare;*
- c) Ligjet;*
- d) Aktet normative të Këshillit të Ministrave”*

dhe për nga hierarkia e tyre ligji prevalon mbi aktet normative të cilat dalin në zbatim të ligjit.

Në interpretim të Kushtetutës dhe dispozitave ligjore dhe nënligjore, paragrafi që KVO ka referuar në arsyetimin e skualifikimit nuk ka vlerë juridike përse kohë i referohet ligji “Për prokurimin publik” dhe nga pikëpamja e teknikës legjislative referenca në Vendimin e Këshillit të Ministrave për licencimin e shoqërive në ndërtim është pa fuqi juridike, pasi ligji i fushës, ligji “Për prokurimin publik” nuk ka kufizime ndërsa aktet nënligjore të dala në bazë dhe zbatim të tij të cilat i referohen nuk kanë asnjë kufizim.

Për këtë shkak ligjor arsytimi i KVO është haptazi i pambështetur në ligjin “Për prokurimin publik” dhe aktet ligjore duke goditur rëndë edhe parimet e barazisë, transparencës dhe përgjegjësisë ndaj ligjit. Nëse shteti shqiptar i përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave do të kishte vendosur kufizime ajo do të ishte vendosur vetëm në ligjin specifik ose në një akt të dalë në bazë dhe në zbatim të ligjit specifik në fushën e prokurimeve publike.

Po ashtu justifikimi i dhënë nga AK se kërkesës së paraqitur për sqarim në eee.app.gov.al i është përgjigjur se mospërfundimi i 70% të fondit të prokuruar në kontratat aktuale me ARRSH do të ishte kriter skualifikimi është i pambështetur ligjërisht. AK në zbatim të nenit 42 të LPP ka detyrimin të japë sqarime për dokumentat e tenderit por të dhënit sqarime nuk do të thotë që nëpërmjet sqarimit AK të ndryshojë kriteret për kualifikim të vendosura në DST dhe shtojcat. AK nëse do të vendoste ndryshimin e dokumentave të tenderit duhej medoemos të hartonte një shtojcë të modifikimit të dokumentave të tenderit, duke shtyrë edhe afatin e hapjes së ofertave për ti dhënë mundësinë çdo operatori të interesuar të njëhej dhe përgatitej për këto ndryshime të kriterëve të DST. Përkundrazi AK sqarimin për kërkesën e regjistruar në sistem kohë më parë, e ka ngarkuar në eee.app.gov.al për t’ja bërë të ditur palëve të interesuara më datë 14.06.2019 ora 13:58 pm, ditë të premtë, ndërsa ofertat dorëzoheshin më datë 17.06.2019 ora 11:00 e hënë. Mesa duket qëllimi i AK nuk ka qenë sqarimi por përdorja e këtij argumenti për qëllime skualifikimi nëse do t’i duhej gjatë vlerësimit të ofertave.

II. Lidhur me pretendimin e dytë të autoritetit kontraktor sqarojmë si vijon:

Në procedurën së cilës i referohet Autoriteti kontraktor, bashkimi i përkohshëm i operatorëve ka tejkaluar kërkesat e vendosura nga AK i asaj procedure. Ky bashkim i OE për të dy procedurat e prokurimit, plotëson kapacitetet teknike të kërkuara në pikat 2.3.2., 2.3.3, 2.3.7 sipas DST. Në lidhje me pikën 2.3.4 bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur secili prej anëtarëve Deklaratat individuale në lidhje me mos angazhimin e inxhinierëve dhe punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.3 për këtë procedurë si dhe Deklaratat mbi disponueshmërinë e mjeteve. AK ka patur të gjithë mundësitë për të kryer verifikimet përkatëse në lidhje me deklaratat e kërkuara si kriter kualifikimi. Në gjykimin tonë periudha kohore e marrë nga AK për procesin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga të 6 ofertuesit është shumë e pamjaftueshme për volumnin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi. Të 5 ofertuesit e skualifikuar janë bashkime operatorësh që do të thotë një volum i madh dokumentacioni për vlerësim përveç dokumentacionit të ofertuesit të kualifikuar i cili sipas sistemit SPE rezulton operator i vetëm. Brenda afatit 3 ditor të kryerjes së vlerësimit kemi bindjen se AK nuk ka kryer asnjë verifikim të dokumentacionit të paraqitur. Për shkak të moszbardhjes dhe vënies në dispozicion të procesverbalit të hapjes së ofertave, i jemi drejtuar AK me shkresën nr. 86 pro., datë 19.06.2019 për paisjen me këtë procesverbal i cili ende nuk na është vënë në dispozicion.

AK përmend në mënyrë të përgjithshme pa specifikuar se cilin nga kapacitetet teknike, profesionale të deklaruara nga ky bashkim operatorësh rezulton i angazhuar në kontratën me objekt “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Lot 4”.

Por në cdo rast Autoriteti kontraktor ka patur të drejtën për të kërkuar dokumentacion shpjegues në lidhje me Deklaratat e dorëzuara nga BO për të gjitha pikat e mësipërme.

Në mënyrë të përmbledhur po ju vëmë në dispozicion përmbledhjen e kapaciteteve teknike të kërkuara në të dy procedurat e prokurimit.

Stafi teknik i kërkuar në pikën 2.3.3 në objektin “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4”

Nr.	Stafi teknik i kërkuar në DST për procedurat e prokurimit	Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4	Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Lori 7	Përmbledhëse
	Drejtues Teknik	Nr stafit të kërkuar	Nr Stafit të kërkuar	Nr Total
1	Inxhinier Ndërtimi	2		2
2	Inxhinier Mjedisi	1		1
3	Inxhinier Hidroteknik	1		1
4	Inxhinier Gjeollog	1		1
5	Inxhinier Elektrik	1		1
6	Inxhinier Mekanik	1		1
7	Inxhinier Gjeoteknik	1		1
8	Inxhinier Markshajder	1		1
9	Inxhinier Topograf	1		1
	Të punësuar staf teknik	Nr	Nr	
1	Inxhinier Ndërtimi	1	2	3
2	Inxhinier Ndërtimi profili infrastrukturë	1		1
3	Inxhinier Hidroteknik		1	1
4	Inxhinier Mekanik		1	1
5	Inxhinier Elektrik	1	2	3
6	Inxhinier Gjeodet/Topograf	1	1	2
7	Inxhinier Ndërtimi	1		1
8	Inxhinier Mjedisi	1	1	2

Fillimisht duam të sqarojmë KVO se numri i stafit i angazhuar në procedurën e prokurimit “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4” ka qenë më i madh se numri i kërkuar nga AK gjatë procedurës së prokurimit. Në stafin e angazhuar për zbatimin e punimeve të objektit “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4” janë kryer ndryshime të stafit të angazhuar në këtë objekt për shkak të arsyeve personale si edhe për qëllime të organizimit teknik të vetë kompanive. Stafi i zëvendësuar plotëson të gjitha kërkesat profesionale dhe disponon të gjitha aftësitë dhe njohuritë e kërkuara për drejtimin dhe ndjekjen e punimeve sipas kërkesave të AK. Sipas neneve 15, 16, 47 dhe 48 të kontratës nr. 6706/6 dt 24.09.2018 të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar është vënë në dijeni Mbikqyrësi i Punimeve (Drejtuesi i Projektit) për të gjitha ndryshimet e stafit teknik të angazhuar. Në përputhje të plotë me Kodin e Punës në fuqi, Kontratat individuale të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit duke kryer zëvendësime të stafit të angazhuar.

Neni 47

Përfaqësimi i palëve

47.1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative që do të jetë përgjegjës në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Nëse sipas kontratës marrëdhëniet e punës mes Punëdhënësit (shoqërive “Gjoka Konstruktion” sh.a apo “Cobial” sh.p.k.) dhe punëmarrësve respektivë të deklaruar në procedurën e lartpërmendur do të përfundonin apo ndërpriteshin për shkaqe nga më të ndryshmet si psh:

- si pasojë e zgjidhjes së njëanshme të kontratës, në zbatim të procedurave dhe afateve të njoftimit,
- shkelje e dispozitave ligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë së Punëdhënësit nga ana e Punëmarrësit;
- neglizhencë e përsëritur në kryerjen e detyrave të punës etj;
- paaftësi e përkohshme apo e përhershme për të punuar;
- vdekje.

Çfarë do të ndodhte me zëvendësimin e stafit /punëmarrësit të deklaruar në tender? Nuk do të zëvendësohej, do të lihej vakant? Bazuar në gjithë legjislacionin në fuqi por duke marrë si shembull edhe praktika të ngjashme, hapi i parë dhe i vetëm që duhet ndërmarrë është njoftimi i mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e zbatimit të punimeve dhe kontratës nga ana e investitorit. Përsa më sipër e njëjta procedurë është ndjekur duke njoftuar mbikqyrësit për zëvendësimet përkatëse me staf të kualifikuar dhe profesional duke mbajtur të angazhuar në objekt numrin total të kërkuar nga AK gjatë procedurës së tenderit. Për zëvendësimet e kryera janë dhënë edhe miratimet përkatëse.

2. 100 Percent

Date: 2/1/21-2019

Lenda. Njoftim mbi mbi ndryshimin e stafit teknik në objektin
"Ndërtim Rruga Kardhiq-Delvinë Loti 4"

MBIKQYRESIT TE PUNIMEVE JV "47 EK 79 & ILIRIADA P K S" sh.p.k. &
"GJEOKONSULT & CO" sh.p.k.
TIRANE

Me ane te le sill ju njoftojme mbi ndryshimet e stafit teknik te angazhuar per zbatimin e punime ne objektin "NDERTIM RRUGA KARDHIQ-DELVINE LOTI 4" me poshte:

1. Largohet Inxhinier Ndertimi Mihalilo Spirofti dhe zevendesohet nga Inxhinier Ndertimi Ili Krasit
2. Largohet Inxhinier Mjedit Gjergji Keruti dhe zevendesohet nga Inxhinier Mjedit Denis Harasani
3. Largohet Inxhinier Hidroteknik Erald Muka dhe zevendesohet nga Inxhinier Hidroteknik Oti Muka
4. Largohet Inxhinier Mekanik Kico Birba dhe zevendesohet nga Inxhinier mekanik Lorenc Tandili
5. Largohet Inxhinier Ndertimi Sokol Dobro dhe zevendesohet nga Inxhinier Ndertimi Robert Kodra
6. Largohet Inxhinier Elektrik Rakip Spahu dhe zevendesohet nga Ing Bardhyl Ruka
7. Largohet Inxhinier Gjoodet Arber Kooli dhe zevendesohet nga Inxhinier Gjoodet Laurant Branollari

Per JV "COBIAL" sh.p.k. & "GJOKA KONSTRUKSION" sh.p.k.



FILMUL PAZA
Pentru o noua zi...

GJOKA
KONTROLI

[illegible]No. 53 prof.Date 3-25-2019

Daftar Isi : INKUISTI DAN PAVARUK
IV "CIR ALBANIA" sh.p.k. dhe "GALFF OMISH & CO ENGINEERING KO"
Perfaqshues nga "CIR ALBANIA" sh.p.k.
n. Roslinda MANSAKU
Rr. "Bumi Prashuri", Nukleosa Nr. 19, Hycja Nr.8, Tiranë

Lënda: Njoftim mbi zëvendësimin e stafit dhe themeluesit të reja të Rrugës së Arbrit

Me përfundimin e punimeve të nenkontraktura nga shoqëria "Gjoka Konstruktion" sh.p. me objekt "Punime ndërtimore "Përmirësim, Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rugës së Arbrit", Fazat I-III Segmenti Nr. 3 "Zall Bazar Dufja Ura e Vashës Km 6+380-14+500 dhe Km 2+380 deri 31+000, L=610,770m përshiri Tunelin T4,T5,T6 si dhe Segmenti Nr.6 Ura e Cerançit -Bilate, Km 60+630-86+760, L=6,140", nga "GJOKA 87" sh.p.k dhe pas "Përmirësim, Ndërtim, Operim dhe Mirëmbajtje e Rugës së Arbrit".

Ju njëpjetorja mbi mosangazhimin me të stafi teknik si vijon dhe zëvendësimitin e tyre me staf teknik të shoqërisë shtet, në luftën me vazhdimësinë e punimeve të tjera të Rrugës në Arbrit:

1. Nuk do të jete me i angazhuar Ing. Ndertimi Sokol Dobes, zvendësohet për vazhdimësi e punimeve nga Ing. Ndertimi Sunda Vathi.
2. Nuk do të jete me i angazhuar Ing. Qjastog Rajmonda Hoxha, zvendësohet për vazhdimësi e punimeve nga Ing. Qjastog Mark Pepkolla.
3. Nuk do të jete me i angazhuar Ing. Mjadosi Gjergji Kercuti, zvendësohet për vazhdimësi e punimeve nga Ing. Mjadosi Ferdinand Fufu.
4. Nuk do të jete me i angazhuar Ing. Elekrik Rakip Spahiu, zvendësohet për vazhdimësi e punimeve nga Ing. Elekrik Arben Lela.

1. Sonda Makineri shpirt mabeli Baumer L2C dhe Makineria per hodhte beton ne tunel.
Meyco Potenza.

Per sa me sipër, ju falenderojmë dhe miqetmi ne pritje te miratimit tuaj.

"Gjaka Konstruktor" sh.a.

Administrative
a. Risk Criteria

III. Lidhur me pretendimin e tretë të autoritetit kontraktor sqarojmë si vijon:

Ligji “Për prokurimin publik”, në fuqi, vetë AK në DST për plotësimin e kriterëve të përgjithshme për kualifikim deklarim nga vetë ofertuesi se:

Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit.

Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik sipas ligjit nr. 8788 datë 07.05.2001 “Për organizatat jofitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me nenin 45/1 të LPP

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore sipas legjislacionit në fuqi.

AK ka kërkuar dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në ditën e hapjes së ofertës sipas Shtojcës 8 për plotësimin e këtyre kriterëve. Në DST përcaktohet në mënyrë taksative se Kriteret e Përgjithshme për Pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Gjithashtu AK në 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim ka kërkuar që operatori ekonomik të ketë një punësim mesatar jo më pak se 130 punonjës për periudhën Janar 2018 – Mars 2019.

Lidhur me sa më sipër Gjoka Konstruksion sha & Geoportal degë e shoqërisë së huaj kanë paraqitur secila individualisht Shtojcën 8 të plotësuar. AK ka detyrimin të vlerësojë dokumentacionin e paraqitur si pjesë të ofertës vetëm në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe periudhat e kërkuara në DST. Megjithatë për të hequr shqetësimin e KVO mbi këto konstatime sqarojmë se:

Sipas Vërtetimit nr. T01028251 dt 2.5.2019 operatori Gjoka Konstruksion sha dhe Vërtetimit nr. 4270 prot., dt 12.06.2019 operatori Geoportal degë e shoqërisë së huaj rezulton që këto dy shoqëri të mos kenë asnjë detyrim tatimor në Tatim mbi të ardhurat nga punësimi, kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore, tatimin e mbajtur në burim, tatim i thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimi mbi vlerën e shtuar.

Detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore të cilat rezultojnë sipas Vërtetimit T01083283 dt 20.05.2019 për Gjoka Konstruksion sha i përkasin kontributeve për muajin Prill 19 ndërsa detyrimet e kontributeve të sigurimeve shoqërore të cilat rezultojnë sipas Vërtetimit T01154361 dt. 13.06.2019 të lëshuar nga Drejtoria tatimore për Geoportal degë e shoqërisë së huaj janë detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore që i përkasin muajit Maj 2019. Pagimi i detyrimeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore të muajit Prill dhe Maj 2019 nuk ka qenë kriter kualifikimi i vendosur nga AK por gjithashtu referuar Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 23 datë 9.12.2014 “Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore” pika 4 “Detyrimi për deklarimin dhe pagesat e kontributeve” përcaktohet se:

“Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë janë të detyruar të deklarojnë në organet tatimore vetëm në formë elektronike të dhënat për kontributet në total dhe për cdo individ brenda afateve të caktuara.

Afatet e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përcaktohen bazuar në statusin e regjistrimit të tatimpaguesve.

- a) Deklarojnë dhe paguajnë çdo muaj brenda datës 20 të muajit pasardhës*
- b) Deklarojnë dhe paguajnë çdo tre muaj mbi baza mujore brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tre mujori të vitit kalendarik”.*

Në mbështetje të Udhëzimit të Ministrit të Financave “Gjoka Konstruktion” sha ka afat ligjor për likuidim të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore brenda datës 20 Maj 2019 dhe Geoportal degë e shoqërisë së huaj ka afat ligjor të likuidimit të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore brenda datës 20 Korrik 2019.

Përsa më sipër detyrimet e kontributeve shoqërore dhe shëndetësore që i përkasin periudhave të pakërkuara nga AK janë të likuiduara plotësisht brenda afateve ligjore. AK ka patur të gjithë mundësinë për verifikimin e vërtetësisë së Deklarimeve të bëra në Shtojcën 8 të kërkuar si dokument në kriteret e kualifikimit por mesa konstatojmë prej nxitimit për vlerësimin e dokumentacionit dhe nxjerrjen e renditjes nuk ka marrë në konsideratë mundësinë për verifikim të vërtetësisë së Deklaratave. Bashkëlidhur gjeni dokumentacionin faktues të likuidimit të kontributeve për periudhat e pakërkuara nga AK në DST.

- Në përputhje me ligjin nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, - nenin 55 “Kriteret e përcaktimit të ofertës fituese” “Oferta fituese duhet të jetë a) oferta që në bazë të kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit plotëson kërkesat e objektit të prokurimit me çmimin më të ulët”.*
- Në përputhje me VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar përkatësisht nenet:
- 58 “Komisioni i Vlerësimit të Ofertave “Komisioni është përgjegjës vetëm për shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertave. Komisioni duhet të zbatojë detyrat në pavarësi të plotë dhe nëse kërkojnë sqarime për dokumentat e tenderit këto merren nga njësia e prokurimit. Komisioni nuk kryen asnjë veprim tjetër përveç atyre të përcaktuara shprehimisht në këto rregulla “ dhe
- nenin 66 “Shqyrtimi dhe Vlerësimi i ofertave” “Pas mbylljes së seancës publike Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara duke kualifikuar vetëm ato oferta që përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit”.*

Për faktin që ky proces vlerësimi në gjykimin tonë ka qenë mjaft i shkurtër në kohë konsiderojmë se të gjitha argumentet e dhëna nga KVO si arsye skualifikimi jo vetëm që nuk qëndrojnë por janë thjesht dhe vetëm artifica për të bërë të mundur skualifikimin e ofertës më të ulët në garë e cila rezulton të jetë me një diferencë prej 509.729.253,75 lekë me ofertën e vetme të kualifikuar nga KVO.

Duke vlerësuar qëllimin e mirë të KVO për ti dhënë jetë këtij projekti sa më parë, parë shpejtësinë me të cilën është punuar për vlerësimin e ofertave do të donim të dinim si është siguruar Kvo mbi vërtetësinë e dokumentacionit të paraqitur nga një shoqëri e huaj e cila datën e regjistrimit të degës së saj në Shqipëri e ka më datë 09.05.2019 dhe në objekt të veprimtarisë së saj sipas QKB është “Aktivitet në fushën e ndërtimit”. Nëse do të verifikoni statutin e kësaj shoqërie do të konstatooni se nuk është e licencuar në projektim ndaj natyrshëm duam të dimë si do ta siguroj projektimin e këtij objekti kur nga sistemi rezulton të jetë operator i vetëm në garë?? Për të gjitha argumentet e dhëna më sipër gjykojmë se në këtë rast nuk kemi të bëjmë me një vlerësim objektiv dhe të paanshëm mbi bazë vetëm të kriterëve për kualifikim të vendosura në DST dhe ligjit.

Duke qenë se kemi përmbushur të gjitha kriteret e përgjithshme dhe ato të veçanta të vendosura nga autoriteti kontraktor në zbatim të ligjit nr. 9643 datë 20.11.200 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, kreu VII: Procedura e Rishikimit Administrativ neni 63/2,3 “Të drejtat e personit të interesuar” dhe kreu X dhe VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, kreu X “Shqyrtimi i ankesave” neni 78 “Ankesat në autoritetin kontraktor”, kërkojmë pezullimin e procedurës së prokurimit dhe shqyrtimin e ankesës duke bërë rivlerësimin e procedurës dhe kualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë përfaqësuar nga “Gjoka Konstruktion” sha dhe renditjen e ofertave të kualifikuara.

II.5. Operatori ekonomik ankimues sqaron se, në datën 01.07.2019, vërtetuar me dokumentacionin postar bashkëngjitur ankesës, u njoh me shkresën nr. 6253/1 prot., datë 28.06.2019, të autoritetit kontraktor, i cili i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues duke mos e pranuar ankesën. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes së ankesës argumenton se:

[...]

1.3.Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nga shqyrtimi i dokumentacionit që gjendet në dosjen e prokurimit si dhe dokumentacionit të hedhur në sistemin e prokurimit publik, konstaton se kriteri i aplikuar nga KVO është i parashikuar në dokumentat e tendeit dhe për më tepër operatori ankimues e pranon edhe vetë se ka qenë i qartë se nga KVO do të zbatoheshin përcaktimet Kreu III, pika 1, paragrafi II b të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar.

1.3.1. Në pikën 2.3.5. të kriterëve të veçanta për kualifikim Shtocja 12 e DST e modifikuar është kërkuar:

Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë licencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të paraqesin licencën përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave nr. 42, datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Shqyrtimi i licencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Licenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

Në dokumentat standarte në kriteret për kualifikim është përcaktuar qartë se gjatë fazës së vlerësimit të ofertave AK do ti referohej dhe bazuar në përcaktimet e VKM nr. 42/2008.

Pikërisht kreu III, pika 1, paragrafi II b të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 është e shkruar qartë se skualifikohet nga ARRSH se smund të shpallet fitues asnjë operator që ska përfunduar 70% të kontratës egzistuese me ARRSH-në.

1.3.2. Vetë operatori ekonomik ankimues pohon se ka marrë dijeni nëpërmjet sqarimeve në sistemin elektronik eëë.app.gov.al mbi përcaktimet e Kreu III, pika 1, paragrafi II b të VKM 42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, VKM mbi të cilën KVO është bazuar dhe ka fuqi ligjore për zbatim.

Lidhur me këtë nuk qëndron as pretendimi i ankuesit se sqarimi i dhënë nga AK lidhur me zbatimin e përcaktimeve do duhej të shoqërohej me shtojcë për modifikim kriteresh për kualifikim. Kjo sepse në këtë rast nuk ka qenë nevoja e as më pak ka qenë detyrim për modifikim apo shtesë kriteresh për kualifikim por thjesht vetëm sqarim mbi kriteret e shpallura në dokumentat e tenderit dhe që mbi bazën e të cilave do të bëhej vlerësimi i ofertave. Është bërë sqarim dhe jo modifikim kriteresh jo vetëm sepse kërkesa e paraqitur ishte kërkesë për sqarim por edhe sepse për njësinë e prokurimit ishte e qartë se zbatimi i përcaktimeve të VKM 42/2008 ishte parashikuar në kriteret për kualifikim. Sqarimi i dhënë e ka bërë edhe më të qartë por edhe lehtësisht të kuptueshme sic kërkohet në rregullat e prokurimit publik.

Pra rezulton se me dokumentacionin e administruar në dosjen e prokurimit si dhe e pohuar e pranuar nga vetë ankimuesi se KVO ka bërë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve për kualifikim të paracaktuara në dokumentat e tenderit nuk ka shtuar ndonjë kriter të paditur për operatorët si dhe në eëë.app.gov.al çdo operator i interesuar i është bërë e qartë se vlerësimi i ofertave do të bëhej duke zbatuar përcaktimet e kreut III, pika 1, paragrafi II b të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar.

1.4. Përcaktimi i VKM 42/2008 ka fuqi ligjore mbi ARRSH pra edhe mbi KVO si pjesë e administratës së ARRSH. Kjo sepse ky përcaktim nuk lë ekuivok për interpretim apo dyzim të çdo zyrtari të ARRSH nëse duhet ta zbatojë ose jo këtë detyrim.

Duke zbatuar këtë përcaktim KVO-ja nuk ka marrë kompetencat e askujt por ka zbatuar me pavarësi të plotë detyrimet e tij ligjore.

Ky përcaktim shprehet qartë se: I ndalohet të kualifikojë si fitues.... kontraktorë.... i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor.

1.5. Përcaktimi i VKM 42/2008 Kreu III, pika 1, paragrafi II b i ndryshuar, parashikon jo vetëm skualifikim të kontraktorit që ska përfunduar 70 % të kontratës që ka me ARRSH por edhe në rastin se supozuar se do të ndodhte që KVO të mos i referohej këtij përcaktimi, atëherë në çdo kohë edhe pas lidhjes së kontratës ajo do të konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e vlerësimit të KVO-së do të ishin nul dhe pa asnjë pasojë juridike. Do të mjaftonte ankimi, por qoftë edhe thjesht një kërkesë për konstatim pavlefshmërie absolute i cilito operatori apo subjekti tjetër të interesuar për këtë procedurë që ARRSH apo Gjykata të detyrohej dhe konstatohej nuliteti i fituesit BO ku Gjoka sha është pjesë dhe nuliteti i kontratës me Gjoka sha si kontraktor (neni 108 i K Pr Administrative).

1.6. Ankuesi është një subjekt i licencuar për zbatim punimesh në fushën e ndërtimit konform përcaktimeve të VKM 42/2008. Gjithë veprimtaria e tij si subjekt zbatues të punimeve në ndërtim bëhet edhe në zbatim të këtyre përcaktimeve. Madje edhe vetë ankimuesi e pranon se i njeh detyrimet që rrjedhin nga kjo VKM dhe është në dijeni të kufizimeve që VKM –ja përcakton për konkurimet e fitimit e kontratave në procedurat e prokurimit që zhvillon ARRSH-jë.

Ankuesi është pjesëmarrës edhe në procedura të mëparshme prokurimi të zhvilluara nga ARRSH ku rasti më i fundit është skualifikimi i tij pikërisht me arsyen e mësipërme nga procedura e zhvilluar nga ARRSH me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja, Loti I”.

Pra ankuesi jo vetëm duhej të ishte në dijeni për shkak të veprimtarisë që ushtron mbështetur në VKM 42/2008 për këtë arsye skualifikimi nga ARRSHja por ka qene në dijeni të kësaj arsye skualifikimi edhe për shkakun se është skualifikuar edhe në raste të mëparshme për këtë arsye.

Fakti që ARRSH është koherente dhe e qëndrueshme në përdorimin e kësaj arsye skualifikimi është detyrim i saj ligjor që rrjedh jo vetëm nga fuqia detyruese e përcaktimeve të VKM 42/2008 por edhe detyrim i zbatimit të rëndësishëm të parashikuar nga K.pr. Administrative si dhe LPP për qëndrueshmërinë në vendimmarrje.

Nqs nga ana e ARRSH në procedura të caktuara apo për operatorë të caktuar do të zbatohet përcaktimi I kreu III, pika 1 paragrafi II b të VKM 42/2008 i ndryshuar, kurse në disa raste të tjera apo operatorë të tjerë nuk do të zbatohet, kjo do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e neneve 4 (parimi i ligjshmërisë), 11 / Ç (parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit), 13 (parimi i drejtësisë dhe paanësisë) e 17 (parimi i barazisë dhe mosdiskriminimit) të KPr Administrative.

Konkretisht në neni 11/Ç K Pr A shprehimisht përcaktohet :

Parimi i ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit

Diskrecioni ushtrohet ligjërisht kur ai është në përputhje me kushtet e mëposhtme:

.....

ç) zgjedhja nuk përbën shmangie të pajustificuar nga vendimet e mëparshme të marra nga i njëjti organ në raste të njëjta apo të ngjashme.

1.7.Nuk qëndron edhe pretendimi se KVO duhet ti referohet vetëm përcaktimeve të VKM 914/2014 dhe DST ku sipas ankuesit nuk është përcaktuar si kriter për kualifikim përfundim i 70% të punimeve të kontratave që operatori mund të ketë me ARRSH pasi Referuar VKM 42/2008 Kreu III, pika 1, paragrafi II b, si dhe moszbatimi përcaktimeve të VKM 42/2008 kreu III, pika 1, paragrafi II.b, i ndryshuar, do të konsiderohet vlerësim sipërfaqësor e formal i kriterëve për kualifikim ndërkohë që KVO ka detyrimin që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim në harmoni me bazën ligjore të aplikueshme për rastin e zbatimit të punimeve në ndërtim në kontratat e lidhura në përfundim të procedurave të prokurimit të fondeve publike.

Përsa më sipër pretendimi i ankuesit lidhur me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron dhe arsyeja e dhënë nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave për skualifikim është plotësisht e mbështetur në LPP, VKM 914/2014, Rregullat e Prokurimit dhe kërkesave të AK për këtë procedurë prokurimi.

2. *Operatori ankues është skualifikuar sipas KVOsë edhe sepse : Kapaciteti teknike profesionale e njerëzore të deklaruara nga BO Gjoka & Cobial shpk rezultojnë të deklaruara dhe të angazhuara edhe në kontratën që ky operator ka në proces zbatimi çka vjen në kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim të pikës 2.3.7/a të kriterëve të veçanta për kualifikim.*

2.2. Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori Gjoka Konstruksion sha ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 të DST ku ka deklaruar listën e makinerive që sipas tij i disponon për realizimin e kontratës subjekt prokurimi si dhe deklaratat për angazhimin e stafit e dokumentacion tjetër të stafit teknik e profesional që do të angazhohet për fazën e zbatimit të kontratës në rast se do të shpalljes fitues.

Por në ankim, ai paraqet pretendime dhe argumenta vetëm për stafin teknik e profesional e nuk shprehet për emra të stafit teknik të deklaruar si dhe nr e fuqisë punëtore.

Natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia e specifika e objektit për ndert, baza ligjore në fuqi kërkojnë që mjetet, numri i kërkuar i fuqisë punëtore si dhe stafi drejtues teknik duhet të jenë të angazhuar vetëm për këtë objekt. Operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknike të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi.

Përsa më sipër pretendimi i ankuesit lidhur me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron.

3. *Lidhur me arsyet e tjera të skualifikimit KVO i është referuar dokumentacionit që vetë operatori ka paraqitur si pjesë së dokumentacionit të ofertës. Ndërkohë që vetë operatori ka paraqitur vërtetim të datës 20.05.2019 ku përshkruhet se ka detyrime, pretendimi i tij për tju referuar një vërtetimi të një date më të hershme nuk konsiderohet i bazuar. Vërtetimi i lëshuar nga organi tatimor në dt më të afërt të hapjes së ofertave përcakton qartë se operatori ka detyrime të papaguar, KVO nuk mund ti referohet një vërtetimi më të hershëm kur konstaton një dokument të fundit se operatori ka detyrime. Nqs do të sihte siç thotë operatori atëherë përse ai ka paraqitur vërtetimet ku dëshmohet se ka detyrime?*

Përsa më sipër pretendimi i ankimuesit lidhur me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron.

II.6. Në datën 09.07.2019, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij.

Konkretisht në ankesën e paraqitur pranë KPP-së operatori ekonomik ankimues argumenton duke ngritur të njëjtat pretendime si edhe në ankesën e paraqitur pranë autoritetit kontraktor.

Në lidhje me kthimin e përgjigjes nga autoriteti kontraktor, operatori ekonomik ankimues argumenton se:

[...]

Kemi bërë ankesë me formularin e ankesës pranë autoritetit kontraktor me datë 26.06.2019. me kthim përgjigje ankesës 6253 prot., datë 26.06.2019 për objekti “Ndërtim Rruga Kardhiq Delvinë loti 7” nr. 6253/1 prot, datë 28.06.2019, ardhur tek ne nëpërmjet shërbimit postar në datë 01.07.2019. Autoriteti kontraktor – Autoriteti Rrugor Shqiptar njofton se ka pezulluar procedurën e prokurimit dhe ka vijuar me ngritjen e komisionit të shqyrtimit të ankesës i cili në përfundim të shqyrtimit të ankesës ka vendosur mospranimin e ankesës sonë.

[...]

Pretendimet tona në lidhje me argumentat e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave:

Pasi jemi njohur me kthim përgjigjen e ankesës nga ana e autoritetit kontraktor – Autoriteti Rrugor Shqiptar, mendojmë se ky autoritet nuk ka bërë asgjë të re, edhe pas paraqitjes së ankimit tonë, përveçse ka vijuar të mbrojë një procedurë vlerësimi, ku kriteret për kualifikim keqinterpretohen nga KVO me qëllim skualifikimin e ofertës tonë.

Në lidhje me pikën 1 (përfshirë të gjitha nënpikat e saj) të përgjigjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave e cila nuk është asgjë tjetër vetëm një përpjekje e këtij komisioni për të legjitimuar një skualifikim të bërë nga KVO mbi bazat e një kriteri vlerësimi inegzistent, parashtrojmë argumentat tona.

Mospërfundimi i 70% të punimeve si kriter skualifikimi bazuar në VKM nr. 42 datë 16.01.2008 jo vetëm që nuk ka qenë kriter i veçantë kualifikimi por as nuk është përmendur fare në asnjë rresht të Dokumentave Standarte të Tenderit. Citimi i vetëm i bërë VKM nr. 42 datë 16.01.2008 në DST i referohej paraqitjes së formatit të licencës sipas kësaj VKM të vitit 2008, kohë në të cilën sipas Vendimit nr. 42, datë 16.01.2008 kushti për përfundimin e 70% të punimeve nuk ka egzistuar.

Autoriteti kontraktor sipas DST faqe 30, ka kërkuar vetëm plotësimin e Shtojcës 11 “Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ose në proces” nga Operatorët ekonomikë. Kjo deklaratë sipas Shtojcë 11 është plotësuar dhe dorëzuar nga anëtarët e BO Gjoka Konstruktion sh.a & Cobia shpk. AK nuk ka vendosur në asnjë rresht të DST si kriter kualifikimi që operatorët ekonomikë ti referohen VKM nr. 42 datë 16.01.2008 dhe as VKM nr. 42 datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b, i ndryshuar për qëllime të përgatitjes së Deklaratës.

I vetmi kriter i vendosur nga Autoriteti kontraktor është plotësimi i kriterit ligjor që operatori ekonomik brenda të njëjtës periudhë nuk është kontraktor / nënkontraktor për kontratë/kontratat të lidhura dhe/ose është shpallur fitues me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100% i kufirit maksimal që disponon sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Marrja dijeni për sqarimin e dhënë 3 ditë përpara hapjes së ofertave të një kërkesë të hedhur në sistem më datë 24.05.2019, ku kërkohej të sqarohej një pyetje e një operatori që nuk ishte një kriter për kualifikim, nuk ka asnjë vlerë ligjore dhe është haptazi një instrument i përdorur për të legjitimuar autoriteti kontraktor veten në skualifikimin e ofertuesve, të cilët nuk do të ishin të preferuar prej kësaj të fundit. Cfarë e ka penguar AK ti përgjigjej kërkesës për sqarim më herët por është dashur të mendohet 22 ditë për kthimin e një përgjigje??? Pyetja e shtruar nuk ka lidhje me Kriteret e Kualifikimit për sa kohë që nuk është kriter kualifikimi nuk mund të përdoret nga KVO në vlerësimin e ofertave.

Në çdo rast LPP parashikon se sqarimet jepen në lidhje me Dokumentat e tenderit. Sqarimi nuk presupozon ndryshim të kriterëve të kualifikimit. Ndryshimi i kriterëve të kualifikimit padiskutim bazuar në ligj, shoqërohet me modifikim dokumentash nëpërmjet një shtojce. KVO në zbatim të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 i ndryshuar ka detyrimin e vlerësimit të dokumentacionit të ofertuesve duke kualifikuar vetëm ato oferta të cilat përmbushin kriteret për kualifikim të përcaktuara në dokumentat e tenderit. KVO i ngritur me urdhër të veçantë të drejtuesit të autoritetit kontraktor nuk ka tagër të shpik kriterë vlerësimi të ndryshme nga sa janë vendosur në DST.

Sa i përket referencës së marrë për analogji në lidhje me skualifikimin e bërë shoqërisë BO përfaqësuar nga Gjoka Konstruktion sha për kriterin e mospërfundimit të 70% të punimeve në procedurën e zhvilluar në datë 14.01.2009 nga ARRSH me objekt “Rehabilitimi i segmentit rrugor mbikalimi pallati me shigjeta rrethrotullimi Shqiponja Loti 1”, sqarojmë se:

- BO nuk ka qene ofertuesi me çmimin më të ulët në atë procedurë që referon AK dhe nuk ka qenë kjo arsyeja e vetme e skualifikimit të BO, mos përfundimi i 70% të punimeve në kontrata të lidhura me ARRSH.
- Po, është ezauruar ankimimi pranë AK për këtë procedurë nga kjo shoqëri përfaqësuese e BO.
- Më datë 01.03.2019 ARRSH ka marrë vendimin e anullimit të procedurës së prokurimit.
- Njolllosja politike dhe përdorimi mediatik i kësaj procedure e bënte të cënueshëm procesin e ankimit në KPP që sigurisht shoqërohet me kosto financiare. Fakti që nuk ishim ofertues me çmimin më të ulët në atë garë, coi një vendim marrje të tillë për të mos e vijuar ankimit në KPP.

Sqaruar sa më sipër AK nuk mund të përdorë këtë argument si unifikim të praktikës së vlerësimit të ofertave, nëpërmjet përdorimit të një kriteri të pavendosur si kusht për kualifikim, duke marrë për analogji një vlerësimin e bërë për një procedurë të mëparshme.

Në lidhje me pikën 2 të përgjigjes së KVO për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri secili prej anëtarëve të BO ka paraqitur deklaratat individuale në lidhje me mos angazhimin e inxhinierëve dhe punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.3. për këtë procedurë si dhe Deklaratat mbi disponueshmërinë e mjeteve ashtu si AK ka kërkuar në kriteret për kualifikim. Në lidhje me emrat për të cilat aludon Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në përgjigjen e ankimit, në arsyen e skualifikimit KVO nuk është shprehur për emra ndaj dhe ne nuk kemi patur asnjë mundësi të gjejmë se kujt emri specifikisht i referohej KVO. Pretendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në përgjigjen e ankimit se operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknik të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi, mund të themi se edhe pse është gjetje e minutës së fundit nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk qëndron. AK disponon në sistem emrat e stafit teknik të deklaruar, njëkohësisht bashkëlidhur gjeni edhe shkresat e njoftimeve të zëvendësimit të stafit. Për qëllime të dokumentimit të ndryshimeve në dispozicion të KPP po bashkëlidhim edhe miratimet përkatëse të zëvendësimeve, pasi AK nuk është investuar fare në lidhje me verifikimet e plotësimit nga ana jonë të këtij kriteri përpara marrjes së vendimit për skualifikim.

Në lidhje me pikën 3 të përgjigjes së Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave ritheksojmë se AK ka kërkuar në kriteret e përgjithshme për kualifikim dorëzimin e Vetëdeklaratës me shkrim të subjektit në ditën e hapjes së ofertës sipas Shtojcës 8 për plotësimin e këtyre kriterëve.

Në DST përcaktohet në mënyrë taksative se kriteret e përgjithshme për pranim nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore. Shtocja 8, ka datë lëshimi 17.06.2019 pra datë të mëparshme krahasuar me Vërtetimet që KVO me shumë zell mer në Vlerësim edhe pse AK nuk i ka kërkuar dokumentacion për plotësimin e kriterëve për kualifikim. Sjellim në vëmendjen tuaj këtë fakt për shkak se Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk ka gjetur dot edhe pse është investuar shumë, asnjë justifikim tjetër përveç pyetjes që shtron se kujt vërtetimi duhej ti referohej KVO atij të mëparshëm? Asnjë shpjegim ligjor nuk ka patur vlerë për Komisionin e Shqyrtimit të Ankesave në lidhje me këtë pikë, përse kohë që mjaftohet me datën e vërtetimeve të pakërkuara për të justifikuar vendimmarrjen e KVO. Ndaj jemi të detyruar të theksojmë se KVO dhe komisioni i shqyrtimit të ankesave duhet të verifikojnë vetëm dokumentacionin e kërkuar si kriter të përgjigjshëm apo të veçantë kualifikimi që autoriteti kontraktor ka vendosur në dokumentat e tenderit, çdo vlerësim përtej këtyre kërkesave është i pabazuar dhe në shkelje flagrante të ligjit.

Duke ritheksuar rezervat tona në lidhje me ofertuesin e vetëm të kualifikuar, shoqëri e huaj e cila me një shpejtësi të madhe ka bërë regjistrimin e degës së saj në QKB më datë 09.05.2019 me objekt veprimtarie “Aktivitet në fushën e ndërtimit” por që nuk rezulton të jetë e licencuar në fushën e projektimit. Nuk jemi të sigurt nëse operatori i kualifikuar përmbush me kaq përpikmëri kërkesat e këtij autoriteti kontraktor, apo autoriteti kontraktor ka qenë selektiv dhe ka verifikuar me kaq kujdes vetëm ofertën e dhënë nga ne si shoqëri?! Ne besojmë që operatori i kualifikuar nuk i përmbush kërkesat por ky pretendim yni mund të verifikohet vetëm nga ju.

Duke mbetur me bindjen se qëllimi i ligjit “Për prokurimin publik” dhe rregullave të dala në zbatim të tij, është ai që ligjvënësi ka patur që në krye të herës pra sigurimin e mirëpërdorimit të fondeve publike nëpërmjet vendosjes së kriterëve të caktuara për rregullimin e fushës së prokurimit publik, duke bërë të mundur që autoritetet kontraktore të vendosin kriteret e kualifikimit në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që prokurohet, duke nxitur pjesëmarrjen dhe konkurrencën e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik, nëpërmjet një trajtimi të barabartë dhe jo diskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik, konsatojmë se skualifikimi ynë me arsyetimet e dhëna nga autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk përputhet aspak me frymën e ligjit, qëllimin e tij, por përkundrazi shkon ndesh me të. Skualifikimi i ofertës më të ulët duke kualifikuar e renditur të parën, një tjetër ofertë të një operatori ekonomik e cila ka një diferencë në çmim prej 509,729,253,75 lekë pa tvsh nga oferta jonë, besojmë se nuk i shërben të mirës publike dhe mirëmenaxhimit të fondeve e aq më pak trajtimin në mënyrë të barabartë, transparente dhe jodiskriminuese të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti kontraktor Autoriteti Rrugor Shqiptar po devijon haptazi nga detyrimi për vlerësim dhe kualifikim të ofertave vetëm mbi bazën e kriterëve për kualifikim të vendosura nga vetë AK njëkohësisht ku kriteri i kualifikimit është çmimi më i ulët, duke na skualifikuar edhe pse përmbushim kriteret e vendosura për kualifikim nga vetë AK duke nxjerrë fituese një ofertë më të lartë ndërkohë që arsyetimet e dhëna për këtë skualifikim janë justifikime të dhëna në favor të autoritetit kontraktor për të legjitimuar kërkesa të cilat nuk kanë qenë kriter kualifikimi.

Pas ndjekjes së të gjitha procedurave të parashikuara me ligj dhe brenda afateve pasi kemi parashtruar të gjithë arsyet e skualifikimit dhe kundërshtimet tona për këto arsye kërkojmë që Komisioni i Prokurimit Publik të marrë në shqyrtim ankesën tonë, të vendosë pezullimin e procedurës konform pikës 8, të nenit 63 të LPP dhe konform gjurmës c) të pikës 3 të nenit 64 të ligjit për prokurimin publik, të anulojë vendimin e autoritetit kontraktor për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, me ofertën më të ulët në këtë procedurë prokurimi.

Kërkojmë që oferta e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj të kualifikohet si ofertë e dhënë në përputhje me kërkesat e ligjit, akteve nënligjore dhe kriterit të përzgjedhjes së fituesit në DST që është çmimi më i ulët.

II.7. Në datën 19.07.2019, nëpërmjet shkresës me nr. 6911/1 prot., datë 16.07.2019, me objekt: “Informacion mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit me objekt “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë Loti 7”, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimes.

Në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor informon si më poshtë vijon:

[...]

Gjatë fazës së publikimit të njoftimit të kontratës deri në hapjen e ofertave në adresë të AK janë paraqitur ankesa lidhur me DT si dhe disa kërkesa për sqarim.

[...]

Lidhur me kërkesat për sqarim është dhënë përgjigje nëpërmjet sistemit elektronik të prokurimit nga NJP në zbatim të përcaktimeve të nenit 42/1 të LPP, sqarimet e dhëna iu janë bërë të ditura të gjithë operatorëve të interesuar duke i botuar sqarimet në SPE pa identifikuar burimin e kërkesës.

Një nga kërkesat për sqarim të paraqitura, me burim të paidentifikuar, kishte të bënte me pyetjen nëse AK gjatë fazës së vlerësimit të ofertave do të zbatonte kriterin për kualifikim që rridhte përcaktimet e VKM 42/2008 për skualifikimin e operatorëve të cilët kanë të papërfunduara 70% të vlerës së kontratës me ARRSH.

Nga ana e NJP është dhënë sqarimi për të gjithë operatorët e interesuar se zbatimi i përcaktimeve të VKM 42/2008 e më specifikisht i përcaktimeve të Kreu III, pika 1, paragrafi II b, i ndryshuar, ku detyrohet ARRSHja të skualifikojë çdo operator që ka të papërfunduara 70% të vlerës së kontratës është përfshirë në DT dhe do të zbatohet nga AK si një detyrim ligjor i ARRSH.

Kjo sepse jo vetëm VKM është në fuqi dhe ka fuqi detyruese mbi ARRSH por edhe sepse kjo është një praktikë e konsoliduar e vendimarrjeve të ARRSH-së edhe në procedura të mëparshme prokurimi.

Ky sqarim është ngarkuar në SPE dhe çdo operator ka patur dijeni për këtë arsye skualifikimi para hapjes së ofertave.

Së pari, në VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. I ndyshuar, thuhet shprehimisht:

“PËRJASHTIM bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t’u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve,

APP dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentat standarte të tenderit dhe dokumentat e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti që skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontratat të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje liçence.

Lidhur sa më sipër, ARRSH (ish DPRR) është detyruar të zbatojë përcaktimet e VKM 42/2008, sepse:

Së pari, siç edhe vetë ankuesi e pranon se kjo VKM është në fuqi dhe ka fuqi detyruese mbi ARRSH-në, por meqenëse zbatimi i saj prek interes të tij, e në këtë rast përbën shkak për skualifikim të ligjshëm, ankuesi pretendon që kjo VKM të zbatohet pjesërisht.

[...]

Së dyti, në VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndyshuar, shprehimisht përcaktohet si detyrim ekskluziv i ARRSH-së, që dokumentat e tenderit t’i përshtaten përcaktimeve të kësaj rregullore.

“...Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin...dokumentat e tenderit me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja...”

Në fakt VKM 42/2008, detyron dhe APP-në që edhe DST t’i përshtasë në përputhje me kësaj rregullore, por fakti që sipas ankuesit APP nuk i ka përshtatur DST në zbatim të kësaj VKM, nuk nënkupton se edhe ARRSH nuk duhet të zbatojë përcaktimet detyruese të VKM 42/2008.

.....

Së treti, përballë ARRSH, në rastin e aplikimit apo jo të kriterit të 70% të përcaktuar në VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. I ndyshuar, shtrohen dy alternative; Të zbatojë këtë VKM vetëm pjesërisht në paragrafin e parë apo tërësisht edhe në pjesën e paragrafit të dytë, që si rast përjashtimor, ka dispozita vetëm për ARRSH-në.

Nga sa më sipër, është krejtësisht e qartë, se ARRSH në rastin e mungesës së një shtojce të veçantë në DST për rastin e ARRSH-së për punët e papërfunduara në masën 70% krahasuar me përcaktimet e VKM 42/2008 e ka detyrim ligjor e duhet të zbatojë e ti referohet aktit që ka nxjerrë një organ më i lartë, siç është Këshilli i Ministrave dhe që është një institucion që ka në varësi APP-në.

.....

Së katërti. Përcaktimi i VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndyshuar, parashikon jo vetëm të kontraktorit që ska përfunduar 70% të kontratës që ka me ARR-në, por edhe rastin e supozuar se do të ndodhte që KVO do të mos i referohej këtij përcaktimi, atëhere në çdo kohë edhe pas lidhjes së kontratës ajo do të konsiderohej absolutisht e pavlefshme dhe efektet e vlerësimit të KVO-së do të ishin nul dhe asnjë pasojë juridike. Do të mjaftonte ankimi, por qoftë edhe thjesht një kërkesë për konstatim pavlefshmërie absolute i cilido operatori apo subjekti tjetër të interesuar për këtë procedurë që ARRSH apo Gjykata të detyrohej dhe konstatohej nuliteti i fituesit dhe kontratës së lidhur. (neni 108 K Pr Administrative).

Së pesti, fakti që ARRSH është koherente dhe e qëndrueshme në përdorimin e kësaj arsye skualifikimi është detyrim i saj ligjor që rrjedh jo vetëm nga fuqia detyruese e përcaktimeve të VKM 42/2008 por edhe detyrim i zbatimit të rëndësishëm të parashikuar nga K Pr Administrative si dhe LPP për qëndrueshmërinë në vendimarrje.

.....

Së gjashti, përcaktimet e VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndyshuar, lidhur me 70%, janë një praktikë e konsoliduar e vendimarrjeve të ARRSH-së edhe në procedurë të mëparshme të prokurimit. Kështu me këtë kriter janë skualifikuar në shumë procedurë operatorë që kanë patur diferencë me operatorin e shpallur fitues, pikërisht se kanë qenë me kontrata me ARRSH-në dhe të papërfunduara në 70% të vlerës së kontratës.

Nqs në procedurën aktuale nuk do të zbatohet ky kriter për skualifikim, çka do të thotë që aplikimi në disa procedurë i këtij kriteri dhe në disa jo, do të përbënte në thelb cënim të parimit të një procesi të rregullt ligjor e administrative sepse do të cënohej parimi i sigurisë juridike.

....

Së shtati, mosaplikimi i përcaktimeve të 70% do të ishte në kundërshtim flagrant me përcaktimet e nenit 4 të K Pr Administrative (Parimi I Ligjshmërisë)

Mos zbatimi i përcaktimeve të VKM nr.42, datë 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. I ndyshuar, do të konsiderohej vlerësim sipërfaqësor e formal i kriterëve për kualifikim ndërkohë që, KVO ka detyrim që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim në harmoni në bazën ligjore të aplikueshme për rastin e zbatimit të punimeve në ndërtim në kontratat të lidhura në përfundim të procedurave të prokurimit të fondeve publike.

1.Nuk qëndron as pretendimi i ankuesit se ky kriter nuk ka qenë i përfshirë në DT dhe se KVO ka përdorur një kriter të paparashikuar në kundërshtim me përcaktimet e nenit 53/2 të LPP, kjo sepse: Së pari, në pikën 2.3.5 të kriterëve të veçanta për kualifikimi shtojca 12 e DST, e modifikuar, është kërkuar; Operatorët ekonomikë duhet të disponojnë liçencat e nevojshme për zbatimin e kontratës. Për këtë duhet të parqesin liçencë përkatëse të shoqërisë, bazuar në formatin e miratuar me VKM Nr.42, datë 16.01.2008 [...].

Shqyrtimi i liçencave do të bëhet mbi bazën e rregullave të parashikuara sa më sipër. Liçenca profesionale e operatorit ekonomik lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës duhet të përmbajë kategoritë e mëposhtme:

.....

Pra shihet qartë se, në DT, në kriteret për kualifikim është përcaktuar qartë se, gjatë fazës së vlerësimit të ofertave AK do t'i referohej dhe zbatonte përcaktimet e VKM 42/2008.

E pikërisht në këtë VKM e më specifikisht Kreu III, pika 1, paragrafi II b, të VKM 42, datë 16.01.2008, është e shkruar e zeza në të bardhë se, skualifikohet në ARRSH dhe smund të shpallet fitues asnjë operator që ska përfunduar 70% të kontratës ekzistuese me ARRSH-në.

Së dyti, siç edhe vet pranon dhe pohon ankimuesi së SPE ëëë.app.gov.al, ai ka marrë dijeni se përcaktimet e Kreu III, pika 1, paragrafi II b, të VKM 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, Kanë fuqi detyruese mbi KVO-në dhe ajo ishte e detyruar të zbatonte ato nëpërmjet sqarimit të dhënë nga AK në SPE. Lidhur me këtë, nuk qëndron as pretendimi i ankuesit se sqarimi i dhënë nga AK lidhur me zbatimin e përcaktimeve do duhej të shoqërohej me një shojcë për modifikim kriteresh për kualifikim. Kjo sepse, në këtë rast nuk ka qënë nevoja e as më pak ka qënë detyrim për modifikim apo shtesë kriteresh për kualifikim, por thjeshtë dhe vetëm sqarim mbi kriteret e shpallura në DT dhe që mbi bazën e të cilave do të bëhej vlerësim i ofertave. Është bërë sqarim dhe jo modifikim kriteresh, jo vetëm sepse kërkesa e paraqitur ishte kërkesë për sqarim por dhe sepse NJP ishte e qartë se zbatimi i përcaktimeve të VKM 42/2008 ishte parashikuar në kriteret për kualifikim. Sqarimi i dhënë e ka bërë edhe më të qartë, por edhe më lehtësisht të kuptueshme edhe për personat me aftësi të kufizuar, siç kërkohet në rregullat e prokurimit publik.

Pra rezulton e provuar me dokumentacionin e administruar në dosjen e prokurimit si dhe e pohuar dhe e pranuar nga vetë ankuesi, se KVO ka bërë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve për kualifikim të paracaktuar në DT, nuk ka shtuar donjë kriter të padtur për operatorët si dhe në ëëë.app.gov.al, çdo operatori të interesuar është bërë e qartë se vlerësimi i ofertave do të bëhej duke zbatuar përcaktimet e Kreu III, pika 1, paragrafi II b, të VKM 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar.

Së treti, operatori ankimues është skualifikuar sipas KVO-së edhe sepse:Kapacitetet teknike, profesionale dhe njerëzore të deklaruara nga BO Gjoka & Cobial sh.p.k, rezultojnë të deklaruara dhe të angazhuara dhe në kontratën që ky operator ka në proces zbatimi, çka vjen në kundërshtim dhe dëshmin mosplotësim të pikës 2.3.7/a të kriterve të veçanta për kualifikim.

Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri, operatori "Gjoka Konstruktion" sh.a, ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 të DST ku ka deklaruar listën e makinerive që sipas tij i disponon për realizimin e kontratës subject prokurimi si dhe deklaratt për angazhimin e stafit e dokumentacin tjetër të stafit teknik dhe profesional që do të angazhohet për fazën e zbatimit të kontratës në rast se do të shpallej fitues.

Por, në ankim ai paraqet pretendime dhe argumenta vetëm për stafin teknik e profesional e nuk shprehet për emrat e stafit teknik të deklaruar dhe numrin e fuqisë punëtore.

Natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia dhe specifika e objektit për ndërtim, baza ligjore në fuqi, kërkojnë që mjetet, numri i kërkuar i fuqisë punëtore si dhe stafi teknik drejtues duhet të jetë angazhuar vetëm për këtë projekt. Operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknik të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim, edhe në kontratën objekt prokurimi.

Për sa më sipër, pretendimi i ankuesit lidhur me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron.

Së katërti, lidhur me arsyet e tjera të skualifikimit, KVO I është referuar dokumentacionit që vetë operatori ka paraqitur si pjesë të dokumentacionit të ofertës. Ndërkohë që vetë operatori ka paraqitur vërtetim të datës 20.05.2019, ku përshkruhet se ka detyrime, pretendimi i tij për tju referuar një vërtetimi të një date më të hershme, nuk konsiderohet i bazuar.

Vërtetimi i lëshuar nga organi tatimor me datë më të afërt të hapjes së ofertave, përcakton qartë se operatori ka detyrime të papaguara. KVO nuk mund t'i referohet një vërtetimi më të hershëm ku konstaton në dokument të fundit se operatori ka detyrime.

Nqs do të ishte siç thotë operatori, atëhere, përse i ka paraqitur vërtetimet ku dëshmohet se ka detyrime?

Përsa më sipër besojmë janë dhënë arsye shteruese e bindëse të mbështetura në ligj dhe praktikën e vendimmarrjeve të ARRSH-së se pretendimet e ankuesit nuk qëndrojnë dhe duhet të lihet në fuqi vendimi i datës 20.06.2019 për skualifikimin e ankuesit.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “2 Bashkimi i operatoreve GJOKA sha & Cobial shpk & GR Albania shpk & Geo Portal dege e shoqerise se huaj , rezulton se nuk ka arritur te paraqese dokumentacion te plote dhe te sakte per te deshmuar plotesimin e te gjithe kriterave per kualifikim dhe kerkesave te AK sic eshte kerkuar ne DT

2.3 Oferta e paraqitur nga ky bashkim operatorësh ekonomik duhet të skualifikohet bazuar në Vendimin e Keshillit të Ministrave nr 42, date 16.01.2008, Kreu III, pika 1, paragrafi II b. i ndryshuar, ku thuhet :

“Përjashtim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila ndalohet të kualifikojë si fitues, për punë publike, të prokuruar sipas ligjit të prokurimit publik, të ndryshuar, kontraktorë, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur,

sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence”.

Operatorët Gjoka Konstruksion sha & Cobial shpk, pjesë e këtij bashkimi me 98.5 % (Gjoka 73.5 % dhe 25 % Cobial) të punëve të marra përisher, rezultojnë të jenë po si bashku si kontraktore me ARRSH-në, për kontratën me objekt Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvine Loti 4, si bashkim i përkohshëm i operatoreve ekonomik Cobial shpk & Gjoka konstruksion sha, për të cilën nuk janë përfunduar 70 % e punimeve të kontraktuara.

Këtë fakt e kanë pranuar edhe vetë operatorët duke e deklaruar në shtojcën 11 si punë në proces përkisht kontratën e sipërpermendur.

Mospërfundimi i 70 % punimeve është shkak skualifikimi jo vetëm i parashikuar në VKM 42/2008 por edhe praktike e vendimarrjes së ARRSH-së edhe në procedurë tjetër të mëparshme prokurimi. Skualifikimi për këtë arsye në këtë procedurë prokurimi është një fakt i njohur për operatorët sepse AK, në përgjigje të një kërkesë për sqarim ka botuar në ëëë.app.gov.al përgjigjen se mospërfundimi i 70 % të fondit të prokuruar në kontrata aktuale me ARRSH do të ishte arsye për skualifikim për çdo operator që do të rezultonte me këtë problematikë”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nga verifikimi në sistemin e prokurimeve elektronike, duke u futur në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në Sistemin e Brendshëm EPS – Seksioni i Autoritetit Kontraktor, e më pas duke u loguar në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi, në rubrikën “Kërkesa”, konstatohet se, është paraqitur një kërkesë nga një operator ekonomik në datën 14.06.2019, në përfundim të shqyrtimit të së cilës, autoriteti kontraktor ka publikuar sqarimin përkatës, po në datën 14.06.2019 (më poshtë paraqitet paraqitja e kërkesës dhe kthimi i përgjigjes nga ana e autoritetit kontraktor, marrë nga sistemi i prokurimeve elektronike).

Kërkesë për sqarim	Ndërtim Rruga Kardhiq - Delvine, Loti 7”	14.6.2019
--------------------	--	-----------

Ankimin	Kërkesa dhe pergjigje Kërkesë Krijuar nga: SULOVA NDERTIM PRODHIM MUSTA NIPT: L43027201P Kërkesë: Kërkesë për sqarim Përshkrimi Material i Bashkangjitur KËRKESË PËR SQARIM.pdf (132,8 kB) Procedurë për Tender Përgjigjia Përfundim Ruaj Tjetër Mbyll	"Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 14.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019
KERKESE PER SQARIM		
Kerkesë për sqarim		
Ankimin		

Ankimin	Kërkesa dhe pergjigje Material i Bashkangjitur KËRKESË PËR SQARIM.pdf (132,8 kB) Procedurë për Tender Përgjigjia Përgjigjia Data e Përgjigjes 14.6.2019 Material i Bashkangjitur PËRGJIGJE SQARIMIT (5).docx (15,3 kB) Bashkangjit Ruaj Tjetër Mbyll	"Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 14.6.2019 "Nderim Rruge Kardihi - Delvine, Loti 7" 6.6.2019
KERKESE PER SQARIM		
Kerkesë për sqarim		
Ankimin		

Konkretisht operatori ekonomik që ka paraqitur ankesën ka kërkuar :

Ne kriteret per kualifikim te shtojca 12 e DST nuk permendet shprehimisht si kriter skualifikues por qe lehtesiht mund te deduktohet duek arsyetuar mbi kriteret e tjera dhe precedentit qe keni vebndour ne procedura te mepareshme sic eshte ai i Unazes Tirane loti 3, per ne qe kemi aktualisht kontrate zbatim punimesh me ARRSH dhe nuk kemi perfunduar punimet ne masen 70 % te kontrates .

Por nderkohe ne kriteret per kualifikim keni kerkuar deklarim mbi punet qe kemi aktualisht ne proces si dhe permendet fakti se vleresimet e operatoreve do te behen edhe mbi bazen e percaktimeve te VKM 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi"

Per te na shkurtuar shpenzimet e pergatitjes se ofertes te cilat nuk jane te pakta si dhe mqs kemi paqartesi mbi kete aplikim ju pyesim direkt ;

1. A do te aplikohet si kriter skualifikues percaktimi qe eshte ne pika 1 paragrafi II.b , KREU III, i VKMse nr 42 /2008, I ndryshuar ku thuhet ; Përfundim bën autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, e cila NDALOHET TË KUALIFIKOJË SI FITUES, PËR PUNË PUBLIKE, TË PROKURUARA SIPAS LIGJIT TË PROKURIMIT PUBLIK, TË NDRYSHUAR, KONTRAKTORË, që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i CILI NUK I KA PËRFUNDUAR PUNIMET NË 70% PËR QIND TË FONDIT TË PROKURUAR NË AUTORITETIN KONTRAKTOR, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve. Agjencia e Prokurimit Publik dhe autoriteti kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve, përshtasin dokumentet standarde të tenderit dhe dokumentet e tenderit, me këtë rregullore dhe garancitë e caktuara me detyrimin, që subjekti të skualifikohet nga pjesëmarrja ose kontrata të shpallet absolutisht e pavlefshme, me detyrimin për njoftim për nisje të procedurës për heqje licence.
Pyetja direkte qe bjeme per sqarim eshte ; A mund kualifikohemi NE kompanite qe per shkaqe te ndryshme qe varen apo nuk varen nga ne , NUK kemi PËRFUNDUAR ENDE PUNIMET NË 70% TË FONDIT TË PROKURUAR te kontrates qe kemi aktualisht me ARRSHne ?

A ndikon shkaku I mosperfundimit te 70 % punimeve (nqs nuk eshte per fajin tone) ne vleresimin qe do te behet nga KVO ?

III.1.2. Autoriteti kontraktor, po në datën 14.06.2019, sipas pasqyrimit të mësipërm të dokumentit (printscreen) ka publikuar në sistemin e prokurimit publik po tek rubrika “Kërkesa ” të kësaj procedure prokurimi, përgjigjen ku ndër të tjera citon si më poshtë :

Ne lidhje me sqarimet qe kerkoni ju bejme me dije se,

1.Per piken e pare ,

ARRSH eshte e detyruar te zbatoje percaktimet e VKM nr 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi".

VKM e mesiperme permбан urdherime detyruese per ARRSH ne cilesine e AK lidhur me perfundimin mbi 70 % te punimeve te kontratave te lidhura . Gjithashtu , keto percaktime nuk lene vend per interpretime subjective nga ana e ARRSH qofte edhe lidhur me shkakun e mosperfundimit te punimeve ne kontratat e lidhura .(ato konsiderohen te parealizuara ne masen 70 % cilido qofte shkaku I mosrealizimit)

Per me teper, qe kjo gje eshte praktike e konsoliduar edhe ne procedura te mepareshme prokurimi qe ka zhvilluar ARRSHja [...].

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, në rubrikën “Njoftimi i kontratës së shpallur”, nga verifikimi i dokumentacionit të publikuar nga autoriteti kontraktor për këtë procedurë prokurimi, rezulton se nuk është publikuar

asnjë sqarim apo shtojcë modifikimi në lidhje me mospërfundimin e punimeve në masën 70% sipas përcaktimeve të VKM nr. 42/2008.

Gjithashtu, në dokumentat e tenderit, që në momentin e publikimit të njoftimit të kontratës nga ana e autoritetit kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike, konstatohet se, nuk është përcaktuar asnjë kriter në lidhje me mospërfundimin e punimeve në masën 70% të fondit të prokuruar, sipas VKM 42/2008.

III.1.4. Lidhur me këtë arsye skualifikimi, e cila në thelb ka të bëjë me rregullimet ligjore përkatëse në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik, vlerëson të ndalet dhe analizojë rregullimet ligjore dhe hierarkinë e zbatimit të tyre, duke vijuar me normat specifike që përcaktojnë kriteret dhe mënyrat e kualifikimit të ofertuesve në procedurat e prokurimit publik dhe marrëdhëniet dhe raportet e mbi/nënvendosjes së tyre.

III.1.5. Neni 116 i Kushtetutës ka përcaktuar hierarkinë e akteve normative, që parashikon marrëdhëniet midis normave juridike, të cilat bazohen në raportin e mbi/nënvendosjes së tyre. Rendi juridik është një sistem hierarkik normash, ku në secilin prej këtyre niveleve qëndron një normë ose grup normash. Aktet normative referuar hierarkisë së tyre kanë në majë Kushtetutën, e cila shërben si burim për aktet e tjera juridike (*shiko vendimet nr.3, datë 20.02.2006; nr.5, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

III.1.6. Neni 118, pika 1 e Kushtetutës parashikon se: *“Aktet nënligjore nxirren në bazë dhe për zbatim të ligjeve nga organet e parashikuara në Kushtetutë”,* ndërsa paragrafi i dytë i këtij neni parashikon se: *“Ligji duhet të autorizojë nxjerrjen e akteve nënligjore, të përcaktojë organin kompetent, çështjen që duhet rregulluar, si dhe parimet në bazë të të cilave nxirren këto akte”.*

Në këto dispozita, është përcaktuar edhe koncepti kushtetues “rezervë ligjore”, sipas të cilës një çështje e rregulluar me ligj mund të detajohet më tej, brenda kufijve të autorizuar nga ligji. Në rastin e rezervës ligjore, aktet nënligjore duhet të nxirren në respektim të kriterëve të përcaktuara në nenin 118 të Kushtetutës, të cilat nga njëra anë e detyrojnë ligjvënësin t’u përmbahet atyre në mënyrë rigoroze dhe nga ana tjetër orientojnë edhe kufizojnë pushtetin ekzekutiv në nxjerrjen e akteve nënligjore (*shiko vendimet nr.17, datë 25.7.2008; nr.12, datë 28.04.2009; nr.24, datë 24.07.2009; nr.7, datë 27.02.2013 të Gjykatës Kushtetuese*).

III.1.7. Komisioni i Prokurimit Publik, për të arritur në vendimmarrje përfundimtare, vlerëson se duhet të ketë parasysh jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese, në të cilën, është shprehur se parimi i shtetit të së drejtës detyron të gjitha organet e pushtetit publik që t’i ushtrojnë kompetencat e tyre vetëm në kuadër dhe në bazë të normave kushtetuese. Aktet juridike që nxirren nga këto organe duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta, si në kuptimin formal, ashtu edhe atë material. Respektimi i hierarkisë së akteve normative është një detyrim që rrjedh nga parimi i shtetit të së drejtës dhe i koherencës në sistemin ligjor (*shiko vendimet nr.1, datë 12.01.2011; nr.23, datë 08.06.2011; nr.2, datë 03.02.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

III.1.8. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, në harmoni me Direktivat respektive të BE, përcakton në mënyrë të qartë se si autoriteti kontraktor kontrollon dhe sigurohet për përshtatshmërinë e operatorëve ekonomikë në drejtim të përputhshmërisë me kërkesat bazë ligjore, si dhe burimet e tyre financiare, përvojën, aftësitë dhe burimet teknike, duke përjashtuar nga procesi i vlerësimit të ofertave ata operatorë ekonomikë që nuk përmbushin kërkesa të tilla.

III.1.9. Në nenin 45 dhe nenin 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, janë përcaktuar kriteret dhe mënyra e administrimit të këtij procesi, që identifikohet si procesi i përzgjedhjes ose kualifikimit, përkatësisht si vijon:

“1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç);

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimin e kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

a) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefishëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në pikat 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

Neni 46

“1. Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret e mëposhtme, që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohet dhe jodiskriminuese:

a) kualifikimi profesional: çdo operatori ekonomik i kërkon licencat profesionale, industriale apo tregtare, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore, për veprimtaritë e kërkuara dhe për të cilat do të lidhet kontrata;

b) aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës;

c) gjendja ekonomike e financiare: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet ekonomike e financiare për të përmbushur kontratën, me anë të deklaratave bankare ose, kur nevojitet, nëpërmjet vërtetimit për sigurim ndaj rreziqeve profesionale, paraqitjes së bilanceve financiare ose të pjesëve të shkëputura nga bilancet, një deklaratë të xhiros së përgjithshme të shoqërisë dhe, në rast nevojë, të xhiros së realizuar nga veprimtaritë e ngjashme me objektin e kontratës që do të prokurohet për një periudhë deri në 3 vitet e fundit financiare, kur ky informacion është i mundur;

ç) kapacitetet ligjore: operatorët ekonomikë vërtetojnë se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi ose, në rastet e bashkimit të shoqërive, vërtetojnë se i gëzojnë këto aftësi në kohën e lidhjes së kontratës.

2. Autoriteti kontraktor mund të kërkojë edhe certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit.

3. Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”.

III.1.10. Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se nga leximi dhe interpretimi i dispozitave të mësipërme ligjore, rezulton qartë, se përzgjedhja e operatorëve ekonomikë përfshin dy faza të dallueshme: fazën ku, autoriteti kontraktor do të vendosë nëse ka shkaqe për përjashtimin e operatorëve ekonomikë nga pjesëmarrja ose jo (neni 45 i LPP); e më pas, fazën ku, autoriteti kontraktor do të shqyrtojë nëse operatorët ekonomikë që nuk janë përjashtuar, plotësojnë kërkesat përkatëse të kualifikimit (neni 46 i LPP) për t'u vlerësuar më tej për ofertën e tyre ekonomike.

Ky proces përfshin në vetvete disa elementë dhe duhet të kryhet duke aplikuar dhe duke u bazuar në kriteret objektive, jo diskriminuese dhe transparente të përzgjedhjes së operatorëve ekonomikë bazuar në nenet 1 dhe 2 të LPP-së, kriteret këto, të cilat hartohen dhe vendosen nga autoriteti kontraktor, publikohen e shpallen në sistemin e prokurimeve elektronike me dokumentat e tenderit dhe formularin e njoftimit të kontratës, për të gjithë operatorët ekonomikë të interesuar për një procedurë prokurimi.

III.1.11. Komisioni i Prokurimit Publik, në kushtet kur çështja në fjalë është e një rëndësie të veçantë, nisur edhe nga natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia e specifika e objektit për ndërtim, i është referuar edhe jurisprudencës së Gjykatës Europiane të Drejtësisë, e cila në çështje të ngjashme (shiko Cështjen C-27/15 Pippo Pizzo) ka konkluduar se, shkaqet e skualifikimit duhet të përcaktohen qartësisht dhe të publikohen paraprakisht në kohë të mjaftueshme, me qëllim që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të njihen me këto shkaqe. GJED në vendimin e mësipërm ka konfirmuar se “përcaktim qartësisht” i shkaqeve të skualifikimit, do të thotë që të garantohet se ofertuesit janë njohur me kërkesat specifike procedurale dhe që të njëjtat kërkesa, aplikohen njëjloj për të gjithë ofertuesit.

Në rastin objekt shqyrtimi, gjykojmë se, aplikimi nga autoriteti kontraktor i kriterit skualifikues sipas VKM nr. 42/2008 (ndryshuar me VKM nr. 835 datë 15.07.2009 Kreu III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr.42, datë 16.01.2008), i vendos në pozita të pabarabarta ofertuesit, që janë në kushtet e mospërfundimit të punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës në kontrata të lidhura me autoritetin kontraktor, në raport kjo me ofertues të tjerë, të cilët mund të jenë në të njëjtat kushte të mospërfundimit të punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, me autoritete të tjera kontraktore qoftë brenda apo jashtë vendit, duke krijuar kështu një trajtim të pabarabartë, si të panevojshëm e të pabazuar.

GJED (po në Cështjen C-27/15 Pippo Pizzo), ka konkluduar se detyrimi i transparencës, duhet të lexohet si ndalesë për autoritetet kontraktore, që të skualifikojnë një ofertues si rezultat i një kriteri, që as nuk është shprehimisht i përfshirë në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit të procedurës në fjalë, si edhe as nuk buron nga ligje në fuqi, por nga rregulla zbatuese dhe interpretime të ligjeve, të nxjerra respektivisht prej autoriteteve kombëtare apo nga jurisprudenca e gjykatave administrative. Në rastin konkret, kriteri skualifikues i përdorur nga autoriteti kontraktor, është pikërisht një rregullim që sipas këtij të fundit, buron pikërisht nga një VKM që konsiderohet si rregull zbatues i një ligji (ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar), normë nënligjore, e cila (referuar sqarimit të mëposhtëm), nuk ka aktualisht as fuqi juridike.

III.1.12. Në lidhje me procedurën objekt shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar në Njoftimin e Kontratës dhe Dokumentat e Tenderit si kriter kualifikimi/skualifikimi faktin që operatorët ekonomikë *“... janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nëkontraktorë, një investim sipas një kontrate të lidhur apo në proces për t'u lidhur, sipas ligjit për prokurimin publik, i cili nuk i ka përfunduar punimet në 70% për qind të fondit të prokuruar në autoritetin kontraktor, Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve”*.

Autoriteti kontraktor e bazon këtë shkak skualifikimi në mbështetje të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, i ndryshuar, Kreu III, pika 1, paragrafi II.b si dhe të praktikës së mëparshme të ndjekur nga vetë autoriteti në të tilla raste.

Komisioni i Prokurimit Publik, në lidhje me sa më sipër, do të ndalet fillimisht në vlerësimin e fuqisë së këtij rregullimi të VKM nr. 42, datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”*, në raport me procedurat e prokurimit publik.

III.1.13. VKM nr. 42, datë 16.01.2008 ka si bazë ligjore të saj nenet 8 dhe 18 të ligjit 8402, datë 10.09.1998, *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”*, i ndryshuar. Vetë kushti skualifikues, të cilit i referohet autoriteti kontraktor në këtë procedurë prokurimi, është parashikuar në këtë VKM nëpërmjet ndryshimit të bërë me VKM nr. 835, datë 15.07.2009, e cila përveç neneve 8 dhe 18 të ligjit 8402, datë 10.09.1998, i referohet edhe shkronjës "b" të pikës 1 të nenit 46 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

Neni 8 i ligjit 8402, datë 10.09.1998, parashikon se: *“Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas apo të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi ka përgjegjësinë e ndërtimit të objektit brenda afateve të përcaktuara në kontratë, në përputhje me projektin, kushtet teknike në fuqi dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standardet kombëtare ose europiane. Me material dhe produkte ndërtimi kuptohet çdo produkt i prodhuar për t’u përfshirë në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit”*, ndërsa neni 18 i këtij ligji parashikon se: *“Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore të nevojshme për zbërthimin dhe zbatimin e këtij ligji”*.

III.1.14. KPP vëren se, dispozitat ligjore të përdorura si bazë për nxjerrjen e VKM –së në fjalë, konkretisht neni 8 i ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, për nga përmbajtja e tij është shterues për atë që ai rregullon dhe nuk përmban asnjë delegim për rregullime të mëtejshme me akte nënligjore të çështjeve të tjera, atë që më pak çështje që lidhen me prokurimin publik. Po kështu, bazë ligjore në nxjerrjen e kësaj VKM-je është neni 18 i po këtij ligji, i cili parashikon një delegim për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbërthim dhe zbatim të këtij ligji.

Nga ana tjetër, në kuptim dhe zbatim të pikës 2 të nenit 118 të Kushtetutës, neni 75 i LPP përcakton se: *“Ngarkohet Këshilli i Ministrave që, brenda 1 muaji nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë rregullat e prokurimit për zbatimin e tij”*. Pra ligjvënësi qartësisht ka përcaktuar që është Këshilli i Ministrave si organi i autorizuar nga ligji, që nëpërmjet rregullave të prokurimit, detajon, rregullon dhe përcakton çështjet konkrete të autorizuar nga ligji i prokurimit publik. Pikërisht në zbatim të kësaj dispozite, Këshilli i Ministrave ka nxjerrë rregullat e prokurimit publik, aktualisht të miratuara me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, i cili ka shfuqizuar rregullat e mëparshme të prokurimit publik të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.1.2007 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar.

III.1.15. Një nga dispozitat e ligjit të prokurimit publik, për të cilat ligjvënësi ka përcaktuar që detajohet nëpërmjet rregullave të prokurimit publik është edhe pika 3 e nenit 46 të këtij ligji, që përcakton se: *“Kërkesat për kualifikim duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm dhe në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*. Detyrimi që kërkesat për kualifikim *“...në çdo rast të jenë sipas përcaktimeve në rregullat e prokurimit publik”*, është parashikuar në ligjin e prokurimit publik me ndryshimet e miratuara me Ligjin nr. 131/2012 *“Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”*, ligj, i cili në vetvete, është përafrim me Direktivën 2004/18/KE të Parlamentit Europian dhe të Këshillit (Direktivë e BE bazë të prokurimit publik, e detyrueshme për transpozim në legjislacionin vendas, deri në vitin 2014 kur u zëvendësua nga Direktiva 2014/24/EU).

III.1.16. Në zbatim pikërisht të pikës 3 të nenit 46 të sipërcituar, dhe nenit 75 të ligjit të prokurimit publik, Këshilli i Ministrave me anë të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, me ndryshimet përkatëse ka miratuar rregullat e prokurimit publik, të cilat detajojnë ndër të tjera në mënyrë ezauruese kërkesat për kualifikim.

III.1.17. Konkretisht, në mënyrë kronologjike, Këshilli i Ministrave çështjen objekt shqyrtimi e ka rregulluar si vijon:

- Me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", në nenin 26, pika 10, është përcaktuar se: *"Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve ndalohej të kualifikojë për punë publike, të prokuruar sipas LPP-së, operatorët ekonomikë që janë fitues dhe/apo kanë në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70 % të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit".*

Komisioni i Prokurimit Publik vëren se, Këshilli i Ministrave me këtë përcaktim identik me atë të Kreut III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr.42 datë 16.01.2008, i ndryshuar, nga pikëpamja e teknikës legjislative, ka transferuar rregullimin e bërë nëpërmjet VKM nr.42, datë 16.01.2008 i ndryshuar, në rregullimet specifike të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, që është edhe akti nënligjor i posaçëm, që miraton rregullat e prokurimit, sipas delegimit të dhënë nga ligjvënësi nëpërmjet nenit 75 të ligjit të prokurimit publik.

Pra, vetë organi i caktuar me ligj për të nxjerrë aktet nënligjore në fushën e prokurimit publik, i ka dhënë vlerë juridike këtij rregullimi, duke e përfshirë atë në rregullat e prokurimit, përndryshe ky përcaktim në VKM nr.42, datë 16.01.2008 të ndryshuar, do të mbetej pa fuqi juridike, për shkak të pamundësisë nga pikëpamja kushtetuese (hierarkia e akteve normative) e VKM nr.42, datë 16.01.2008 të ndryshuar, për të rregulluar çështje të prokurimit publik, kjo, si për shkak të kufizimeve që burojnë nga natyra e ndryshme e Ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998, i ndryshuar, që është baza e VKM nr.42 datë 16.01.2008, ashtu edhe për shkak të kufizimit që buron nga pika 3 e nenit 46 të LPP, që përcakton se, i vetmi rregullim nënligjor i lejuar për kërkesat për kualifikim është ai nëpërmjet rregullave të prokurimit.

- Me VKM Nr. 402 datë, 13.05.2015, në nenin 26 është zëvendësuar emërtimi "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve" me emërtimin "Autoriteti Rrugor Shqiptar" dhe në pikën 10 të nenit 26 është shtuar përcaktimi që: *"Ky kusht nuk do të zbatohet nëse operatorët ekonomikë janë kontraktorë/nënkontraktorë në një investim/investime dhe nuk i kanë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, për shkak të përligjura, si vijon: i) vonesa si pasojë e ndërthurjes me një vepër tjetër në ndërtim, si: KUZ, OSHEE etj.; ii) dëmtimi apo dalja në dritë e objekteve me vlera historike; iii) vonesa në shpronësimin e subjekteve, të cilave u përket prona; iv) ndryshim në prioritetet e qeverisjes në financim; v) rishpërndarje të fondeve si pasojë e ndonjë emergjence, të justifikuara nga autoriteti kontraktor, sipas dokumentacionit të lëshuar nga ky i fundit.*

Në çdo rast, një vërtetim i tillë nuk do të lëshohet për subjektet nëse, sipas grafikut të punimeve, pjesë e kontratës, deri në periudhën në fjalë, ato nuk do të mund të kishin kryer më shumë se 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës".

Pra, me ndryshimet në vijim, Këshilli i Ministrave, së pari, si organ i autorizuar nga ligji i prokurimit publik, për të përcaktuar këtë rregullim nënligjor të kërkesave për kualifikim, ka zëvendësuar emrin e autoritetit kontraktor nga "Drejtoria e Përgjithshme e Rrugëve" në "Autoriteti Rrugor Shqiptar", në përputhje edhe me Ligjin Nr. 10 164, datë 15.10.2009 "Për Autoritetin Rrugor Shqiptar" dhe së dyti, e ka modifikuar kërkesën, duke mos e konsideruar më kusht automatikisht skualifikimi, mospërfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, dhe duke përcaktuar rastet përjashtimore për mospërfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës për shkaqe të përligjura. Në thelb, me këtë ndryshim, është zbutur mënyrën e aplikimit të kësaj kërkeje skualifikuese, duke e lënë të tillë, pra skualifikuese, vetëm për rastet kur mospërfundimi është në thelb mospërmbyllje e kontratës nga ana e operatorit ekonomik, e duke lehtësuar në këtë mënyrë operatorët ekonomikë të interesuar për të konkuruar në procedura të tilla prokurimi.

- Akoma më tej, me VKM nr. 797, datë 29.12.2017 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar", është shfuqizuar pika 10 e nenit 26 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014, i ndryshuar dhe është shtuar gërma "ç" në pikën 8 të nenit 26 si vijon: "Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që nuk është fitues dhe/apo ka në proces, në të njëjtën kohë, si kontraktorë/nënkontraktorë, një investim/investime, sipas një kontrate apo kontratave të lidhura a në proces për t'u lidhur, sipas LPP-së, i cili në çastin e hapjes së ofertave nuk i ka përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës. Përcaktimi i mësipërm vlen edhe për rastin e bashkimit të operatorëve, ku secili prej tyre, për t'u kualifikuar për punë publike, duhet të ketë përfunduar punimet fizike, në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, që ai ka marrë përsipër të realizojë në përputhje me kontratën e bashkëpunimit".
- Me VKM nr. 80, datë 14.2.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, gërma "ç" në pikën 8 të nenit 26 është shfuqizuar. Theksojmë se kjo VKM, është nxjerrë me shënimin që: "... synon të përafrojë pjesërisht Direktivën 2014/24/BE, datë 26 shkurt 2014, të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, për prokurimin publik, që shfuqizon Direktivën 2004/18/KE-CELEX:32014L0024".

III.1.18. Sa më sipër analizuar, nga parashtrimet e mësipërme të kronologjisë së ndryshimeve të përcaktimit që ka shërbyer si shkak skualifikimi në lidhje me "mospërfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës", dhe analizën ligjore në tërësi, rezulton qartë sa vijon:

- VKM nr. 835, datë 15.07.2009, e cila ka ndryshuar Kreun III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr. 42, datë 16.01.2008, nuk ka kryer thjesht një zbërthim ose sqarim të dispozitave të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit" dhe bërjen të mundur të zbatimit të këtyre dispozitave, por duke marrë përsipër të rregullojë një

fushë më të gjerë se ajo e deleguar nga ligji sipas përcaktimit të nenit 118, pika 1 të Kushtetutës;

- Nga momenti i hyrjes në fuqi të ndryshimeve të pikës 3 të nenit 46 të ligjit të prokurimit publik, miratuar me Ligjin nr. 131/2012 "Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për Prokurimin Publik", rregullimet e bëra nga VKM nr. 835, datë 15.07.2009 që ndryshon Kreun III, pika 1, paragrafi II.b të VKM nr.42, datë 16.01.2008, e kanë humbur fuqinë juridike, pasi në kuptim të nenit 118, pika 1 të Kushtetutës dhe nenit 75 ligjit të prokurimit publik, vetëm rregullat e prokurimit publik, mund të rregullojnë, detajojnë dhe zbërthejnë çështje të lidhura me procedurat e prokurimit publik, përfshirë edhe kërkesat për kualifikim;
- Nga momenti i hyrjes në fuqi të VKM nr. 80, datë 14.2.2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në Vendimin nr. 914, datë 29.12.2014, të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", të ndryshuar", kriteri skualifikues i referuar nga autoriteti kontraktor në lidhje me mospërfundimin e punimeve në masën 70% të vëllimeve të përgjithshme të punës, e ka humbur fuqinë juridike, dhe nuk mund të përdoret si shkak për skualifikimin e operatorit ekonomik;
- Komisioni i Prokurimit Publik, sjell në vëmendje, nenin 55, pika 2 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, ku parashikohet *"Autoriteti kontraktor vlerëson dhe krahason ofertat e vlefshme, për të përcaktuar ofertën fituese, në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit. Nuk duhet të përdoret asnjë kriter, që nuk është përfshirë në dokumentet e tenderit"*. Sqarimi i dhënë nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike në datë 14.06.2019, në përgjigje të një kërkesë për sqarim të depozituar më datë 14.06.2019, përveçse është në kundërshtim me afatet e vendosura nga neni 42 i LPP, i cili përcakton se: *"1. Ofertuesi i mundshëm mund të kërkojë sqarime për dokumentet e tenderit nga autoriteti kontraktor, i cili duhet t'i përgjigjet çdo kërkesë për sqarim të dokumenteve të tenderit, të bërë nga çdo operator ekonomik, me kusht që kërkesa të jetë marrë jo më vonë se 5 ditë para afatit përfundimtar të dorëzimit të ofertave. Autoriteti kontraktor duhet të përgjigjet brenda 3 ditëve nga depozitimi i kërkesës, në mënyrë që të bëjë të mundur dorëzimin e ofertës në kohë nga operatori ekonomik dhe, pa identifikuar burimin e kërkesës, duhet t'ia komunikojë sqarimin përkatës të gjithë operatorëve ekonomikë, që kanë tërhequr dokumentet e tenderit"*, nuk mund të konsiderohet si një shtim kriteri/kërkesë për kualifikim, pasi nuk është publikuar si shtojcë në dokumentat e tenderit dhe as nuk është shoqëruar me shtyrje të afatit të hapjes së ofertave sipas përcaktimeve të nenit 42 të ligjit të prokurimit publik.

Në këtë kuptim, Komisioni konstaton se, ky është një kriter i pakërkuar nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit, dhe si i tillë nuk mund të përdoret për skualifikimin e operatorëve ekonomikë pjesëmarrës;

- Argumenti i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave, se operatorët ekonomikë janë njoftuar në pikën 2.3 të Shtojcës 12 të dokumentave të tenderit për përdorimin si referencë për këtë qëllim të VKM nr.42, datë 16.01.2008, nuk qëndron, pasi e vetmja referencë e bërë në këtë VKM në Shtojcën 12 është pika 2.3.5, në lidhje me formatin e kërkuar të licensës, ku përcaktohet se: *"Operatorët ekonomike duhet të disponojnë licensat e nevojshme për*

zbatimin e kontrates. Per kete duhet te paraqesin licensen perkatese te shoqerise, bazuar ne formatin e miratuar me Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, "Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi".

- Vetë Autoriteti Kontraktor në Shtojcën 11 të Dokumentave të Tenderit "Deklaratë mbi kontratat e lidhura dhe/ ose ne proces", ka sqaruar se *"Kjo deklarate ka si qellim plotesimin e kriterit ligjor qe operatori ekonomik brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura dhe/ose është shpallur fitues, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent"*.

Në këtë kontekst, në funksion edhe të parimit të transparencës të përcaktuar nga neni 2 (b) i ligjit të prokurimit publik, Komisioni i Prokurimit Publik, thekson se, për sa kohë autoriteti kontraktor u ka bërë të njohur, si më sipër, qëllimin dhe funksionin e kësaj deklarate, nuk mundet që ta përdorë informacionin e përftuar prej saj për qëllime të tjera, të cilat nuk iu janë njoftuar paraprakisht operatorëve ekonomikë të interesuar, si shënimi i sipërcituar;

- Jurisprudenca e zgjeruar dhe e konsoliduar e GJED, mbështet gjithashtu konkluzionin se:
 - a) Ndalohejt përdorimi i listave zyrtare automatike të përjashtimit të lidhura formën ligjore apo me cilësitë profesionale të ofertuesve potencialë;
 - b) Edhe nëse kriteret përjashtuese vendosen në funksion të mbrojtjes së konkurrencës, këto duhet të jenë proporcionale dhe nuk duhet të shkojnë përtej asaj që është e nevojshme për të arritur objektivin, që përfshin edhe përdorimin me efikasitet dhe efikasitet të fondeve publike;
 - c) Autoritetet kontraktore nuk mund të skualifikojnë një ofertues, si rezultat i një kriteri, që as nuk është shprehimisht i përfshirë në njoftimin e kontratës dhe dokumentat e tenderit të procedurës në fjalë, dhe as nuk buron nga ligje në fuqi, por nga rregulla zbatuese (akte nënligjore) të nxjerra respektivisht prej autoriteteve kombëtare apo nga interpretime të gjykatave.

III.1.19. Në vijim të sa më sipër, referuar edhe informacionit dhe dokumentacionit të depozituar nga autoriteti kontraktor pranë Komisionit të Prokurimit, konstatohet se, vetë autoriteti kontraktor, citon që aktet më të ulëta duhet të jenë në pajtim me aktet juridike më të larta si në kuptimin formal, ashtu edhe në atë material. Gjithashtu, autoriteti kontraktor sqaron se KVO ka detyrim që të bëjë analizë në themel dhe të arsyeshme të kriterëve për kualifikim, ndërkohë që, rezulton se, në asnjë moment nuk është hartuar dhe parashikuar një kriter i qartë dhe i saktë, i cili do të shërbejë si kriter kualifikimi/skualifikimi, në dokumentat e tenderit të kësaj procedure prokurimi në lidhje me zbatimin/moszbatimin e VKM 42/2008, përse i përket mospërfundimit të punimeve në masën 70%. Autoriteti kontraktor nuk mund t'i referohet kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.5 të dokumentave të tenderit, ndërkohë që ky kriter ka të bëjë me diçka krejt të ndryshme nga kriteri për aplikimin e përfundimit të punimeve në masën 70%.

Pra, vetë autoriteti kontraktor nuk është i qartë dhe është kontradiktor, pasi në informacionin e dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, citon se vlerësimi është bërë në bazë të kriterëve të hartuara në dokumentat e tenderit, kur ndërkohë nuk ka një kriter të tillë të parashikuar në dokumentat e tenderit, e për më tepër që nga ana tjetër, po vetë autoriteti kontraktor citon, se është

bërë një sqarim në dokumentat e tenderit (i cili siç sqaruam edhe më lart është bërë në kundërshtim me parashikimet e nenit 42 të ligjit të prokurimit publik, përsa i përket afatit të paraqitjes së tij pranë autoritetit kontraktor). Në këtë mënyrë autoriteti kontraktor, ka legjitimuar faktin, se nuk ka hartuar asnjë kriter në lidhje me mospërfundimin e punimeve në masën 70%, pasi ka nxjerrë thjesht një sqarim në lidhje me dokumentat e tenderit.

Komisioni i Prokurimit Publik, sqaron se, referuar ligjit dhe rregullave të prokurimit publik në fuqi, termi “sqarim” në vetvete ka për qëllim sqarimin në lidhje me dokumentat e tenderit, kriteret e përcaktuara në to, kur janë te paqarta e të pakuptueshme, e si i tillë nuk mundet që një sqarim të legjitimohet si një kriter i ri, e për më tepër ky sqarim të shërbejë si një element kualifikimi/skualifikimi.

III.1.20. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit.

Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme, në mbështetje edhe të pikës 3, të nenit 66 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.

Rrjedhimisht, sa më sipër analizuar, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “2.4 Kapacitetet teknike, profesionale e njerezore te deklaruar nga BO Gjoka & Cobia shpk , rezultojne te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontraten qe ky operator ka ne proces zbatimi, cka vjen ne kundërshtim dhe deshmon mosplotesim te pikes 2.3.7/a te kriterëve te vecanta per kualifikim”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 12, pika 2.3.7/a, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar kriteri:

2.3.7 Operatori ekonomik duhet te disponoje mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike per realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund t’i vihen ne dispozicion operatorit ekonomik.

a) Kerkohen te jene ne dispozicion keto mjete pune:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Kamiona vetshkarkues min 20 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
2	Kamiona vetshkarkues 10 deri 18 ton	Copë	4	Në pronësi ose me qera
3	Kamiona vetshkarkues 5 deri 10 ton	Copë	3	Në pronësi ose me qera

4	Kamioncine deri 4.5 ton	Copë	2	Në pronësi ose me qera
5	Jumbo dhe/ose sonde shpimi per tunele	Copë	3	Në pronësi ose me qera
6	Cekic pneumatik	Copë	3	Në pronësi ose me qera
7	Makine troketimi	Copë	2	Në pronësi ose me qera
8	Autobot Uji	Copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Autobot naftë	Copë	1	Në pronësi ose me qera
10	Depozitë Uji (5.000 Litra)	Copë	2	Në pronësi ose me qera
11	Autobetoniere	Copë	4	Në pronësi ose me qera
12	Autopompë Betoni	Copë	3	Në pronësi ose me qera
13	Motobetoniere	Copë	3	Në pronësi ose me qera
14	Pompa Uji	Copë	2	Në pronësi ose me qera
15	Autovinc	Copë	1	Në pronësi ose me qera
16	Fadrome me goma	Copë	2	Në pronësi ose me qera
17	Mini fadrom	Copë	2	Në pronësi ose me qera
18	Eskavator me kovë dhe çekiq pneumatik	Copë	1	Në pronësi ose me qera
19	Eskavator me zinxhirë	Copë	2	Në pronësi ose me qera
20	Minieskavatore	Copë	2	Në pronësi ose me qera
21	Autobitumatrice	Copë	1	Në pronësi ose me qera
22	Greider	Copë	1	Në pronësi ose me qera
23	Rul ngjeshes	Copë	2	Në pronësi ose me qera
24	Buldozer	Copë	1	Në pronësi ose me qera
25	Asfalto shtruese	Copë	1	Në pronësi ose me qera
26	Gjenerator	Copë	2	Në pronësi ose me qera
27	Vibrator	Copë	3	Në pronësi ose me qera
28	Paisje për hekurkthyes (tranxhe / elektrobanjo)	Copë	1	Në pronësi ose me qera
29	Gurethyesë fronto	Copë	1	Në pronësi ose me qera
30	Nyje inerte e paisur leje mjedisore	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
31	Fabrike asfalti	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi
32	Fabrike prodhim betoni	Copë	1	Në pronësi ose me qera ose kontrate furnizimi

Të deklaroje mjetet dhe pajisje të mbrojtjes në punë të punëtorëve, personelit si më poshtë:

- Kokore minimumi 100 (njqind) copë
- Jelekë minimumi 100 (njqind) copë
- Fikëse zjarri të lëvizshme minimumi 10 (dhjetë) copë
- Prozhektorë ndriçimi natën minimumi 5 (pesë) copë
- Komplet i ndihmës së shpejtë minimumi 10 (dhjete) copë
- Tabela paralajmëruese për sigurinë në objekt minimumi 20 (Njëzetë) copë

- *Mjetet mund të jene ne pronesi ose me qera .
Ne rast se mjetet nuk jane ne pronesi apo me qera mund te paraqiten Akt Marrëveshje porosie/Kontratë e Porosie/kontrate leasing/ ose Marreveshje per shitjen me kusht te mjeteve ose cdo forme tjeter kontrate ekuivalente me to e te njohura nga legjislacioni shqiptar . Kontratat apo marreveshjet e sipercituara duhet të jenë lidhur përpara noterit dhe duhet të përmbajnë të dhënat e sakta në lidhje me tipin e mjetit, të dhënat teknike për mjetin, kushtet e kontratës /marrëveshjes si dhe afatin për ekzekutimin e saj*
- *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që vertetojne pronesine e mjetit:- certifikaten e pronesise; -leja e qarkullimit; -certifikaten e kontrollit teknik; siguracionin ; leja e transportit qe leshohet nga njesia vendore dhe fotot perkatese; ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur jane ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, ndersa per mjete te marra me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase e cila duhet te perfshije objektin perkates dhe duhet te jete e vlefshme per te gjithë periudhen deri ne perfundimin e plote te punimeve.*
- *Për fabriken e asfaltit dhe betonit, nese eshte ne pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes apo çdoganimit, fotot dhe fatura tatimore perkatese, leja mjedisore leshuar nga QKL. Nese eshte marre me qera krahas dokumentacionit te mesiperm, duhet te paraqitet edhe kontrata e qerase. Operatori ekonomik per fabriken e asfaltit dhe betonit mund te paraqese edhe kontrata te vlefshme furnizimi me operatore ekonomike Ne kete rast duhet te paraqese kontraten e furnizimit dhe dokumentacionin qe verteton ekzistencen dhe pronesine e impiantit.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me shkrim për disponueshmërinë e mjeteve gjatë gjithë periudhës së komntrates.*
- *Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku Autoriteti Kontraktor rezervon • të drejtën të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve, me apo pa lajmërim paraprak, si dhe te beje deklarimin e adreses se sakte te vendodhjes se mjeteve me qellim verifikimin e tyre”*

Autoriteti Kontraktor rezervon te drejten te verifikojë vertetesine e deklarates. Ne rast deklarimi te rreme do te veprohet ne perputhje me nenin 13, pika 3, germa "a" te Ligjit Nr.9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar, "Per Prokurimin Publik".

III.2.2. Operatori ekonomik në ankesën e paraqitur pretendon se: “Në procedurën së cilës i referohet Autoriteti kontraktor, bashkimi i përkohshëm i operatorëve ka tejkaluar kërkesat e vendosura nga AK i asaj procedure. Ky bashkim i OE për të dy procedurat e prokurimit, plotëson kapacitetet teknike të kërkuara në pikat 2.3.2., 2.3.3, 2.3.7 sipas DST. Në lidhje me pikën 2.3.4 bashkimi i operatorëve ekonomikë ka paraqitur secili prej anëtarëve Deklaratat individuale në lidhje me mos angazhimin e inxhinierëve dhe punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.3 për këtë procedurë si dhe Deklaratat mbi disponueshmërinë e mjeteve. AK ka patur të gjithë mundësitë për të kryer verifikimet përkatëse në lidhje me deklaratat e kërkuara si kriter kualifikimi.

Në gjykimin tonë periudha kohore e marrë nga AK për procesin e vlerësimit të dokumentacionit të paraqitur nga të 6 ofertuesit është shumë e pamjaftueshme për volumin e dokumentacionit të kësaj procedure prokurimi. Të 5 ofertuesit e skualifikuar janë bashkime operatorësh që do të thotë një volum i madh dokumentacioni për vlerësim përveç dokumentacionit të ofertuesit të kualifikuar i cili sipas sistemit SPE rezulton operator i vetëm. Brenda afatit 3 ditor të kryerjes së vlerësimit kemi bindjen se AK nuk ka kryer asnjë verifikim të dokumentacionit të paraqitur.

Për shkak të moszbardhjes dhe vënies në dispozicion të procesverbalit të hapjes së ofertave, i jemi drejtuar AK me shkresën nr. 86 pro., datë 19.06.2019 për paisjen me këtë procesverbal i cili ende nuk na është vënë në dispozicion.

AK përmend në mënyrë të përgjithshme pa specifikuar se cilin nga kapacitetet teknike, profesionale të deklaruara nga ky bashkim operatorësh rezulton i angazhuar në kontratën me objekt “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Lot 4”.

Por në cdo rast Autoriteti kontraktor ka patur të drejtën për të kërkuar dokumentacion shpjegues në lidhje me Deklaratat e dorëzuara nga BO për të gjitha pikat e mësipërme.

Në mënyrë të përmbledhur po ju vëmë në dispozicion përmbledhjen e kapaciteteve teknike të kërkuara në të dy procedurat e prokurimit.

Stafi teknik i kërkuar në pikën 2.3.3 në objektin “Ndërtim rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4”

[...]

Fillimisht duam të sqarojmë KVO se numri i stafit i angazhuar në procedurën e prokurimit “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4” ka qenë më i madh se numri i kërkuar nga AK gjatë procedurës së prokurimit. Në stafin e angazhuar për zbatimin e punimeve të objektit “Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë Loti 4” janë kryer ndryshime të stafit të angazhuar në këtë objekt për shkak të arsyeve personale si edhe për qëllime të organizimit teknik të vetë kompanive. Stafi i zëvendësuar plotëson të gjitha kërkesat profesionale dhe disponon të gjitha aftësitë dhe njohuritë e kërkuara për drejtimin dhe ndjekjen e punimeve sipas kërkesave të AK. Sipas neneve 15, 16, 47 dhe 48 të kontratës nr. 6706/6 dt 24.09.2018 të lidhur me Autoritetin Rrugor Shqiptar është vënë në dijeni Mbikqyrësi i Punimeve (Drejtuesi i Projektit) për të gjitha ndryshimet e stafit teknik të angazhuar. Në përputhje të plotë me Kodin e Punës në fuqi, Kontratat individuale të punës mes punëdhënësit dhe punëmarrësit duke kryer zëvendësime të stafit të angazhuar.

Neni 47

Përfaqësimi i palëve

47.1. Çdo palë duhet të emërojë me shkrim një person ose strukturë organizative që do të jetë përgjegjës në emër të palës, për marrjen e komunikatave dhe për përfaqësimin e palës në çështjet e lidhura me ekzekutimin e kontratës.

47.2 Secila palë duhet të lajmërojë palën tjetër menjëherë për ndonjë ndryshim në emërimin e përfaqësuesit të palës. Nëse njëra palë dështon të lajmërojë duhet të marri përsipër çdo humbje të shkaktuar nga dështimi për të dhënë njoftim të mjaftueshëm.

47.3 Palët mund të emërojnë persona ose struktura organizative shtesë për të përfaqësuar palën në veprime ose veprimtari të veçanta në të cilin rast njoftimi me shkrim duhet dhënë dhe duhet të përcaktojë shtrirjen e autoritetit të përfaqësuesit.

Neni 48

48.1 Çdo lajmërim i dhënë nga njëra palë tjetrës sipas kontratës duhet të bëhet me shkrim në adresën e specifikuar në kontratë.

48.2 Njoftimi do të ketë efekt sapo të dorëzohet.

Nëse sipas kontratës marrëdhëniet e punës mes Punëdhënësit (shoqërive “Gjoka Konstruktion” sh.a apo “Cobial” sh.p.k.) dhe punëmarrësve respektivë të deklaruar në procedurën e lartpërmendur do të përfundonin apo ndërpriteshin për shkaqe nga më të ndryshmet si psh:

- si pasojë e zgjidhjes së njëanshme të kontratës, në zbatim të procedurave dhe afateve të njoftimit,
- shkelje e dispozitave ligjore që rregullojnë fushën e veprimtarisë së Punëdhënësit nga ana e Punëmarrësit;
- neglizhencë e përsëritur në kryerjen e detyrave të punës etj;
- paaftësi e përkohshme apo e përhershme për të punuar;
- vdekje.

Çfarë do të ndodhte me zëvendësimin e stafit /punëmarrësit të deklaruar në tender? Nuk do të zëvendësohej, do të lihej vakant? Bazuar në gjithë legjislacionin në fuqi por duke marrë si shembull edhe praktika të ngjashme, hapi i parë dhe i vetëm që duhet ndërmarrë është njoftimi i mbikqyrësit të caktuar për ndjekjen e zbatimit të punimeve dhe kontratës nga ana e investitorit.

Përsa më sipër e njëjta procedurë është ndjekur duke njoftuar mbikqyrësit për zëvendësimet përkatëse me staf të kualifikuar dhe profesional duke mbajtur të angazhuar në objekt numrin total të kërkuar nga AK gjatë procedurës së tenderit. Për zëvendësimet e kryera janë dhënë edhe miratimet përkatëse”.

Në lidhje me pikën 2 të përgjigjes së KVO për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri secili prej anëtarëve të BO ka paraqitur deklaratat individuale në lidhje me mos angazhimin e inxhinierëve dhe punonjësve të kërkuar në pikën 2.3.3. për këtë procedurë si dhe Deklaratat mbi disponueshmërinë e mjeteve ashtu si AK ka kërkuar në kriteret për kualifikim. Në lidhje me emrat për të cilat aludon Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave në përgjigjen e ankimit, në arsyen e skualifikimit KVO nuk është shprehur për emra ndaj dhe ne nuk kemi patur asnjë mundësi të gjejmë se kujt emri specifikisht i referohej KVO. Pretendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave në përgjigjen e ankimit se operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknik të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi, mund të themi se edhe pse është gjetje e minutës së fundit nga Komisioni i Shqyrtimit të Ankesave nuk qëndron. AK disponon në sistem emrat e stafit teknik të deklaruar, njëkohësisht bashkëlidhur gjeni edhe shkresat e njoftimeve të zëvendësimit të stafit. Për qëllime të dokumentimit të ndryshimeve në dispozicion të KPP po bashkëlidhim edhe miratimet përkatëse të zëvendësimeve, pasi AK nuk është investuar fare në lidhje me verifikimet e plotësimit nga ana jonë të këtij kriteri përpara marrjes së vendimit për skualifikim”.

III.2.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues argumenton: “Operatori ankues është skualifikuar sipas KVOsë edhe sepse : Kapaciteti teknike profesionale e njerëzore të deklaruar nga BO Gjoka & Cobial shpk rezultojnë të deklaruar dhe të angazhuara edhe në kontratën që ky operator ka në proces zbatimi çka vjen në kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim të pikës 2.3.7/a të kriterëve të veçanta për kualifikim.

Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori Gjoka Konstruksion sha ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 të DST ku ka deklaruar listën e makinerive që sipas tij i disponon për realizimin e kontratës subjekt prokurimi si dhe deklaratat për angazhimin e stafit e dokumentacion tjetër të stafit teknik e profesional që do të angazhohet për fazën e zbatimit të kontratës në rast se do të shpalljes fitues.

Por në ankim, ai paraqet pretendime dhe argumenta vetëm për stafin teknik e profesional e nuk shprehet për emra të stafit teknik të deklaruar si dhe nr e fuqisë punëtore.

Natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia e specifika e objektit për ndert, baza ligjore në fuqi kërkojnë që mjetet, numri i kërkuar i fuqisë punëtore si dhe stafi drejtues teknik duhet të jenë të angazhuar vetëm për këtë objekt. Operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknike të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi.

Përsa më sipër pretendimi i ankuesit lidhur me këtë arsye skualifikimi nuk qëndron”.

III.2.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë bashkëpunimi me nr. 839 rep, nr. 441 kol, e lidhur në datën 14.06.2019, ndërmjet shoqërisë “ Gjoka Konstruksion” sh.a., shoqërisë ” Cobial” sh.p.k., ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “ Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Marrëveshje për bashkim të përkohshëm, me nr. 828 rep. Nr. 431 kol, e lidhur në datën 13.06.2019, ndërmjet shoqërive ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, nga ku shoqëria ”GR Albania” sh.p.k. merr përsipër 55% të të zërave të shërbimit dhe shoqëria “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj merr përsipër 45% të zërave të shërbimit.

Në kontratën e bashkëpunimit me nr. 839 rep, nr. 441 kol, e lidhur në datën 14.06.2019, rezulton se shoqëria “Gjoka Konstruksion” sh.a. merr përsipër për realizimin e objektit të mësipërm në masën 73.5%, ”Cobial” sh.p.k. merr përsipër në masën 25%, bashkimi i shoqërive sipas marrëveshjes së bashkimit të përkohshëm nr. 828 rep. nr. 431 kol, e lidhur në datën 13.06.2019, shoqëritë ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj do të kryejnë 1.5% të punimeve (shërbimi i projektimit), sipas tabelës së ndarjeve të punimeve, bashkëlidhur.

III.2.5. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatorët ekonomikë si anëtarë të bashkimit të operatorëve, rezulton se janë paraqitur:

Shoqëria “Cobial” sh.p.k.:

- Shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive e shoqërisë “Cobial” sh.p.k.
- Deklaratë mbi makineritë e operatorit ekonomik ”Cobial” sh.p.k. ku deklarohet se: ”Makineritë e deklaruara sipas shtojcës 10 janë të disponueshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve sipas kontratës. Makineritë e deklaruara sipas Shtojës 10 dhe që janë në pronësi të shoqërisë ”Cobial” sh.p.k. ndodhen në Kantjerin Majkosh Tepelenë ndërsa makineritë dhe mjetet e marra me qera ndodhen në adresat e qeradhënësve në Tiranë.

Autorizohet autoriteti kontraktor të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me ose pa paralajmërim paraprak.

Shoqëria "Gjoka Konstruksion" sh.a.:

- Shtojca 10 Mbi disponimin e makinerive e shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sh.a.
- Deklaratë e operatorit ekonomik "Gjoka Konstruksion" sh.a., në të cilën deklarohet se: "Makineritë e deklaruar sipas Shtojcës 10 janë të disponueshme gjatë gjithë periudhës së realizimit të punimeve sipas kontratës.

Makineritë e deklaruar sipas Shtojcës 10 dhe që janë në pronësi të shoqërisë "Gjoka Konstruksion" sh.a. ndodhen në kantierin e ndërtimit të shoqërisë në Tapizë – Kamëz.

Autorizohet autoriteti kontraktor të bëjë verifikimin e mjeteve në çdo kohë dhe pa paralajmërim, mjetet dhe pajisjet janë të parkuara / stacionuara në kantierin e ndërtimit të shoqërisë në Tapizë – Kamëz.

Ndërsa mjetet me qira, ndodhen të parkuara në:

Kantierin e shoqërisë "Arjel" sh.p.k. në Kamëz.

Kantierin e shoqërisë "Sina 98" sh.p.k. pranë ish Uzinës së Autotraktorëve, Tiranë

Kantierin e shoqërisë "Ge.Co" sh.p.k. në Kombinat Tiranë

Kantierin e shoqërisë "Almo Konstruksion" sh.p.k. në rrugën nacionale Zall Mner i Ri.

Autorizohet autoriteti kontraktor të kryejë në çdo kohë verifikimin fizik të disponueshmërisë së mjeteve me apo pa paralajmërim paraprak

III.2.6. Në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se: "*Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese*".

III.2.7. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 "*Për prokurimin publik*", i ndryshuar, parashikohet se: "*Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...*".

III.2.8. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", i ndryshuar, neni 29, pika 8, parashikohet si më poshtë: "*Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

- a) *licenca profesionale të shoqërisë për realizimin e punimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe/ose*
- b) *dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*
- c) *dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*
- ç)
- d) *Vetëdeklarim nga operatori ekonomik që brenda së njëjtës periudhë nuk është kontraktor/nënkontraktor për kontratë/kontrata të lidhura, me vlerë të përbashkët ose të veçantë, jo më të madhe se 100 % i kufirit maksimal, që disponon kandidati, sipas licencës profesionale, të lëshuar nga autoriteti kompetent.*

Në kuptim të përcaktimit të mësipërm, fjala “periudhë” nënkupton kohëzgjatjen e investimit të kryer sipas LPP-së nga çasti i shpalljes fitues e deri në kolaudimin e objektit/investimit.

III.2.9. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t’i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”

III.2.10. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimues si edhe në informacionin dhe dokumentacionin e depozituar pranë KPP-së, argumenton se operatorit ekonomik “Gjoka Konstruktion” sh.a. ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 të DST ku ka deklaruar listën e makinerive që sipas tij i disponon për realizimin e kontratës subjekt prokurimi si dhe deklaratat për angazhimin e stafit e dokumentacion tjetër të stafit teknik e profesional që do të angazhohet për fazën e zbatimit të kontratës në rast se do të shpalljes fitues.

Por në ankim, ai paraqet pretendime dhe argumenta vetëm për stafin teknik e profesional e nuk shprehet për emra të stafit teknik të deklaruar si dhe nr e fuqisë punëtore.

Natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia e specifika e objektit për ndert, baza ligjore në fuqi kërkojnë që mjetet, numri i kërkuar i fuqisë punëtore si dhe stafi drejtues teknik duhet të jenë të angazhuar vetëm për këtë objekt. Operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknike të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi.

III.2.11. Komisioni i Prokurimit Publik do të ndalet në lidhje me veprimet e autoritetit kontraktor në lidhje me këtë procedurë prokurimi dhe konkretisht në lidhje me arsyen e skualifikimit të dhënë për këtë bashkim operatorësh ekonomikë.

Fillimisht, referuar informacionit dhe dokumentacionit të operatorit ekonomik ankimues, dokumentacionit e informacionit të autoritetit kontraktor, si edhe nga verifikimi i kryer në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se, autoriteti kontraktor ka qenë i paqartë gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave dhe kontradiktor në lidhje me këtë arsye skualifikimi.

Konkretisht, referuar arsyes së skualifikimit të dhënë në sistemin e prokurimeve publike, autoriteti kontraktor ka argumentuar se *kapacitetet teknike, profesionale e njerezore te deklaruar nga BO Gjoka & Cobia shpk , rezultojne te deklaruar dhe te angazhuara edhe ne kontraten qe ky operator ka ne proces zbatimi, cka vjen ne kundërshtim dhe deshmon mosplotesim te pikes 2.3.7/a te kriterëve te vecanta per kualifikim*”, që referuar dokumentave të tenderit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në sistemin e prokurimeve elektronike nuk rezulton të jetë kërkuar ndonjë dokument i tillë ose të jetë përcaktuar një kriter i tillë.

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Autoriteti kontraktor do të konsiderojë një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.

Në rastin konkret, nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentave të tenderit, rezulton se nga autoriteti kontraktor nuk është përcaktuar apo vendosur ndonjë kërkesë në lidhje me deklarinimin për mosangazhimin e mjeteve në kontrata të tjera që ky operator ekonomik ka në proces zbatimi.

Autoriteti kontraktor duhet të bëjë vlerësimin e ofertave mbi bazën e kriterëve të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duke përjashtuar këtu vlerësimin mbi dokumenta shtesë të pakërkua nga autoriteti kontraktor.

Për pasojë, gjykojmë se operatorët ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi duhet të plotësojnë vetëm kërkesat e vendosura në dokumentat e tenderit e, rrjedhimisht, vlerësimi e kualifikimi i tyre duhet të bëhet në përputhje vetëm me këto kërkesa.

Në rastin në shqyrtim, në kushtet kur nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar dhe përcaktuar një kërkesë e tillë, përmbushja e kriterit në lidhje me mjetet provohet nëpërmjet plotësimin të kriterëve të kërkuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

III.2.12. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: *“Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”*. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: *“Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”,* ndërsa në pikën 3 parashikohet: *“Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”*.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.2.13. Akoma më tej, autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit të dhënë në sistemin e prokurimit publik, përveç faktit që vlerëson mbi një kriter të pakërkuar, ka dhënë një arsye skualifikimi të përgjithshme, të pa specifikuar dhe të padetajuar se cilën pikë të kriterit 2.3.7/a nuk ka plotësuar operatori ekonomik ankimes, por përmend në mënyrë përgjithësuese pa dhënë detajet dhe arsyet përkatëse, se cili nga kapacitetet teknike, profesionale të deklaruara nga ky bashkim operatorësh ekonomikë nuk plotësohet, dhe ashtu sicc sqarohet dhe argumentohet më

poshtë, autoriteti kontraktor është organi që ka barrën për të provuar nëse operatori ekonomik nuk ka përmbushur kriterin e përcaktuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit.

Autoriteti kontraktor, është organi përgjegjës për zhvillimin e procedurës së prokurimit bazuar edhe në parimet e mosdiskriminimit, trajtimit të barabartë e mirëpërdorimit të fondeve publike.

III.2.14. Në Nenin 55, pika 4 të ligjit nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet se: *“Autoriteti kontraktor duhet të përgatisë një përshkrim të shkurtër të procesit të vlerësimit, i cili pasqyrohet në procesverbal, në përputhje me nenin 12 të këtij ligji. Në rastin e prokurimit me mjete elektronike, sistemi administron automatikisht të dhënat, vlerësimet dhe komentet mbi to, duke njoftuar, në rrugë elektronike, ofertuesit”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se autoriteti kontraktor, edhe në dokumentacionin dhe informacionin e depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, për këtë procedurë prokurimi, nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion, detaj apo element specifik se për cilin element të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.7/a nuk është përmbushur nga ana e operatorit ekonomik ankimues, pasi thjesht citon që *“Kapacitetet teknike, profesionale e njerëzore të deklaruara nga BO Gjoka & Cobial shpk, rezultojnë të deklaruara dhe të angazhuara edhe në kontratën që ky operator ka në proces zbatimi, çka vjen në kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim të pikës 2.3.7/a të kriterëve të veçanta për kualifikim”*, pa provuar se cilat janë këto kapacitete që janë të deklaruara dhe angazhuara në kontratë tjetër, në kushtet kur është po vetë ky autoritet kontraktor që disponon dokumentacionin për kontratën e pretenduar.

Është detyrë e autoritetit kontraktor të vërtetojë, faktojë e provojë me dokumentacion çdo argumentim të përdorur si arsye skualifikimi për një operator ekonomik pjesëmarrës në një procedurë prokurimi, e si rrjedhim autoriteti kontraktor ka edhe barrën e provës në rastin e përcaktimit të arsyeve të skualifikimit.

III.2.15. Së fundi, rezulton se, autoriteti kontraktor (në korrespondencën e mbajtur me operatorin ekonomik në lidhje me shqyrtimin e ankesës), ka përmendur këtë argumentim *“Për të dëshmuar plotësimin e këtij kriteri operatori Gjoka Konstruksion sha ka paraqitur deklaratën sipas shtojcës 10 të DST ku ka deklaruar listën e makinerive që sipas tij i disponon për realizimin e kontratës subjekt prokurimi si dhe deklaratat për angazhimin e stafit e dokumentacion tjetër të stafit teknik e profesional që do të angazhohet për fazën e zbatimit të kontratës në rast se do të shpalljes fitues. Por në ankim, ai paraqet pretendime dhe argumenta vetëm për stafin teknik e profesional e nuk shprehet për emra të stafit teknik të deklaruar si dhe nr e fuqisë punëtore. Natyra e punimeve, vlera e kontratës, rëndësia e specifika e objektit për ndert, baza ligjore në fuqi kërkojnë që mjetet, numri i kërkuar i fuqisë punëtore si dhe stafi drejtues teknik duhet të jenë të angazhuar vetëm për këtë objekt. Operatorët kanë deklaruar të njëjtin staf teknike të angazhuar edhe në kontratën që ka në zbatim edhe në kontratën objekt prokurimi”*, e cila nuk është evidentuar në sistemin elektronik të Agjencisë së Prokurimit Publik nga anëtarët e KVO-së, pasi në sistemin e prokurimeve elektronike operatori ekonomik ankimues, rezulton i skualifikuar me arsyen: *“[...] Operatori ankues është skualifikuar sipas KVOsë edhe sepse: Kapaciteti teknike profesionale e njerëzore të deklaruara nga BO Gjoka & Cobial shpk rezultojnë të deklaruara dhe të angazhuara edhe në kontratën që ky operator ka në proces zbatimi çka vjen në kundërshtim dhe dëshmon mosplotësim të pikës 2.3.7/a të kriterëve të veçanta për kualifikim”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, nga ana e autoritetit kontraktor nuk është respektuar procedura (rivlerësimi i procedurës së prokurimit në sistemin elektronik të prokurimeve duke rinjoftuar për të gjitha arsyet e mundshme për skualifikim të ofertës), në mënyrë që t'i jepej mundësi operatorit të ankimojë të gjitha pretendimet e ngritura për skualifikimin e ofertës së tij pranë autoritetit kontraktor, siç parashikohet në pikën 2, nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar si dhe në pikën 5, të nenit 78 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se pretendime të tilla, “të reja”, të evidentuara në kundërshtim me parashikimet e legjislacionit për prokurimin publik të mos i marrë në shqyrtim.

Rrjedhimisht sa më sipër, argumentuar pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues se arsyeja e skualifikimit “2.5 Operatori duhet të skualifikohet në zbatim të përcaktimeve të nenit 45 të LPP sepse një nga pjesëtarët e këtij bashkimi operatorësh, konkretisht operatori Gjoka sha, ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore që sipas ligjit punedhenesi paguan për punemarësit e tij. Gjoka sha ka paraqitur vertetimin T 01083283 dt 20.05.2019 të leshuar nga Drejtoria tatimore ku deshohet se ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore. Po kështu edhe një nga pjesëtarët e tjerë të këtij bashkimi, Gjeo portal dege e shoqërise se huaj ka detyrime të papaguara. Geoportal dege e shoqërise se huaj ka paraqitur vertetimin nr T 01154361 dt 13.06.2019 të leshuar nga drejtoria tatimore ku konfirmohet se ka të papaguara detyrime të kontributeve të sigurimeve shoqërore”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në dokumentat e tenderit Shtojca 12, Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/Kualifikimit është përcaktuar:

“Ofertuesi duhet të deklarojë se:

a) Është i regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit. Në rastin kur ofertuesi është një organizatë jofitimprurëse, duhet të deklarojë se është i regjistruar si person juridik, sipas Ligjit Nr.8788, datë 07.05.2001 “Për Organizatat jo Fitimprurëse”.

b) nuk është në proces falimentimi, (statusi aktiv)

c) nuk është dënuar për shkelje penale, në përputhje me Nenin 45/1 të LPP,

ç) nuk është dënuar me vendim të gjykatës së formës së prerë, për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale.

d) ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi.

Edhe Ofertuesi i huaj duhet të deklarojë se i plotëson të gjitha kërkesat e renditura më sipër nëpërmjet paraqitjes së një vetëdeklarate me shkrim.

Nëse gjuha e përdorur në procedurë është gjuha shqipe, atëherë dokumentat në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen me një përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vetëdeklaratën e lartpërmendur.

Kriteret e Përgjithshme për Pranim, nuk duhet të ndryshohen nga autoritetet kontraktore.

Këto kritere duhet të plotësohen me dorëzimin e vetëdeklaratës me shkrim të subjektit, në ditën e hapjes së ofertës, sipas Shtojcës 8.

Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër”.

III.3.2. Në pikën 2.3. Kapaciteti teknik, pika 2.3.2., nga autoriteti kontraktor është përcaktuar kriteri: *“2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar, jo më pak se 130 punonjes, për periudhën (Janar 2018 – Mars 2019), e vërtetuar kjo me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e kërkuar, shoqëruar me formularët E-SIG të konfirmuara nga organet perkatese (me nënshkrim elektronik ose në hard copy)”.*

III.3.3. Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes drejtuar operatorit ekonomik ankimes argumenton: *“Lidhur me arsyet e tjera të skualifikimit KVO i është referuar dokumentacionit që vetë operatori ka paraqitur si pjesë së dokumentacionit të ofertës. Ndërkohë që vetë operatori ka paraqitur vërtetim të datës 20.05.2019 ku përshkruhet se ka detyrime, pretendimi i tij për tju referuar një vërtetimi të një date më të hershme nuk konsiderohet i bazuar. Vërtetimi i lëshuar nga organi tatimor në dt më të afërt të hapjes së ofertave përcakton qartë se operatori ka detyrime të papaguar, KVO nuk mund ti referohet një vërtetimi më të hershëm kur konstaton një dokument të fundit se operatori ka detyrime. Nqs do të sihte siç thotë operatori atëherë përse ai ka paraqitur vërtetimet ku dëshmohet se ka detyrime”.*

III.3.4. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruktion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, rezulton se, është paraqitur dokumenti me emërtimin Kontratë bashkëpunimi me nr. 839 rep, nr. 441 kol, e lidhur në datën 14.06.2019, ndërmjet shoqërisë “ Gjoka Konstruktion” sh.a., shoqërisë ” Cobial” sh.p.k., ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “ Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj.

Gjithashtu është paraqitur edhe dokumenti Marrëveshje për bashkim të përkohshëm, me nr. 828 rep. Nr. 431 kol, e lidhur në datën 13.06.2019, ndërmjet shoqërive ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, nga ku shoqëria ”GR Albania” sh.p.k. merr përsipër 55% të të zërave të shërbimit dhe shoqëria “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj merr përsipër 45% të zërave të shërbimit.

Në kontratën e bashkëpunimit me nr. 839 rep, nr. 441 kol, e lidhur në datën 14.06.2019, rezulton se shoqëria “Gjoka Konstruktion” sh.a. merr përsipër për realizimin e objektit të mësipërm në masën 73.5%, ” Cobial” sh.p.k. merr përsipër në masën 25%, bashkimi i shoqërive sipas marrëveshjes së bashkimit të përkohshëm nr. 828 rep. nr. 431 kol, e lidhur në datën 13.06.2019, shoqëritë ”GR Albania” sh.p.k. dhe shoqërisë “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj do të kryejnë 1.5% të punimeve (shërbimi i projektimit), sipas tabelës së ndarjeve të punimeve, bashkëlidhur.

III.3.5. Referuar kriterit të përcaktuar në dokumentat e tenderit, nga shqyrtimi i dokumentacionit të ngarkuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga operatorët ekonomikë si anëtarë të bashkimit të operatorëve, rezulton se janë paraqitur:

Shoqëria "Gjoka Konstruktion" sh.a.:

- Shtojca 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme", ku ndër të tjera deklarohet se "Operatori ekonomik "Gjoka Konstruktion" sh.a. ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi", e në fund të deklaratës është përcaktuar: *"Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër"*.
- Vërtetim (për pagim detyrimesh) me nr. T01028251, datë 02.05.2019, ku deklarohet se: *"Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar derimë datën 02.05.2019, ora 08:47:36"*
- Vërtetim (Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a), me nr. T01028239, datë 02.05.2019, ku deklarohet lista me numrin e punonjësve për periudhën Qershor 2016 – Mars 2019, dhe në fund të këtij dokumenti deklarohet:
Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 02.05.2019, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 02.05.2019, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 0 lekë detyrime, nga të cilat:
Kontribute gjithsej: 0 lekë
Kamatvonesa për kontributet: 0 lekë
Gjobat lidhur me kontributet: 0 lekë
Ky vërtetim lëshohet mbi të dhënat e administruara nga sistemi informatik tatimor deri më datë 02.05.2019, ora 08:45:19
- Vërtetim (Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a), me nr. T01083283, datë 20.05.2019, ku deklarohet lista me numrin e punonjësve për periudhën Qershor 2016 – Prill 2019, dhe në fund të këtij dokumenti deklarohet:
Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 20.05.2019, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 20.05.2019, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 6,624,055 lekë detyrime, nga të cilat:
Kontribute gjithsej: 6,624,055 lekë
Kamatvonesa për kontributet: 0 lekë
Gjobat lidhur me kontributet: 0 lekë
Ky vërtetim lëshohet mbi të dhënat e administruara nga sistemi informatik tatimor deri më datë 20.05.2019, ora 14:58:50

Shoqëria "Geoportal" d.o.o. degë e shoqërisë së huaj:

- Shtojca 8 "Deklaratë mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme", ku ndër të tjera deklarohet se "Operatori ekonomik "Geoportal" d.o.o. degë e shoqërisë së huaj ka paguar të gjitha detyrimet për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi", e në fund të deklaratës është përcaktuar: *"Në çdo rast, autoriteti kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër"*.
- Vërtetim me nr. 4270 prot., datë 12.06.2019 ku deklarohet se: *"Vërtetojmë se tatimpaguesi Geoportal d.o.o. [...] rezulton se për periudhën deri në datën 11.06.2019 nuk ka asnjë detyrim tatimor në Tatim mbi të Ardhurat nga Punësimi, Kontribute e Sigurime Shoqërore*

dhe Shëndetësore, Tatimin e Mbajtur në Burim, Tatim i Thjeshtuar mbi Fitimin dhe Tatim Mbi Vlerën e Shtuar”

- Vërtetim (Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a), me nr. T01154361, datë 13.06.2019, ku deklarohet lista me numrin e punonjësve për periudhën Shtator 2016 – Maj 2019, dhe në fund të këtij dokumenti deklarohet:

Nga të dhënat për kontributet të regjistruara në organin tatimor deri në datën 13.06.2019, që pasqyrojnë faktin e subjektit deri në datën 13.06.2019, rezulton se ky subjekt ka për të paguar gjithsej 8370 lekë detyrime, nga të cilat:

Kontribute gjithsej: 8370 lekë

Kamatvonesa për kontributet: 0 lekë

Gjobat lidhur me kontributet: 0 lekë

Ky vërtetim lëshohet mbi të dhënat e administruara nga sistemi informatik tatimor deri më datë 13.06.2019, ora 10:27:52

III.3.6. Në nenin 45 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *”Për prokurimin publik”*, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se:

1. Autoriteti kontraktor skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:

a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë e armatosur, organizatë terroriste;

b) korrupsion;

c) mashtrim;

ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;

d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;

dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;

e) falsifikim;

ë) shfrytëzim i punës së të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.

Detyrimi për të skualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, operator ekonomik, ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

2. Çdo operator ekonomik skualifikohet nga një procedurë, në rastet kur:

a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;

b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;

c) është dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;

ç);

d) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

dh) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;

e) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre.

ë) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit, sipas pikës 3, të nenit 13, të këtij ligji.

3. Me qëllim plotësimit të kushteve të parashikuara në pikat 1 dhe 2 të këtij neni, operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin si më poshtë:

d) Vërtetim nga dosja gjyqësore, ose një dokument të njëvlefshëm, të lëshuar nga një autoritet kompetent gjyqësor apo administrativ që vërteton se nuk ekzistojnë kushtet e parashikuara në 1 dhe 2, shkronja “a”, “b” dhe “c”.

b) një vërtetim të lëshuar nga organi kompetent, që vërteton se nuk ekzistojnë çështjet e përmendura në pikën 2 shkronjat “d” e “dh”.

Ndërsa, në nenin 46, pika 1 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.

III.3.7. Në nenin 53, pika 3 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”.

III.3.8. Në Kreun VIII, neni 74, “Bashkimi i operatorëve ekonomikë”, pika 1 e VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet: “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe në rast përzgjedhjeje edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi”. Në Kreun VIII, neni 74, pika 2 po këtu, parashikohet: “Para dorëzimit të ofertës, bashkimi duhet të krijohet zyrtarisht, me një marrëveshje të noterizuar, ku të përcaktohen përfaqësuesi i grupit, përqindja e pjesëmarrjes së punës/shërbimit/furnizimit dhe elementet konkrete, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi. Pas krijimit të bashkimit të operatorëve ekonomikë, anëtarët e bashkimit caktojnë me prokurë përfaqësuesin e tyre për dorëzimin e ofertës. Kjo marrëveshje e shkruar dhe prokura duhet të dërgohen së bashku me kualifikimet dhe ofertën ekonomike, e cila duhet të nënshkruhet nga përfaqësuesi...”, ndërsa në pikën 3 parashikohet: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat ligjore, të parashikuara në nenin 45 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit.

Kërkesat ekonomike, financiare, profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje”.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë dhe përvojën e duhur, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi, si edhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion.

III.3.9. Referuar legjislacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] *aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]*”

III.3.10. Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur në sistemin e prokurimeve elektronike, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se nga ana e operatorëve ekonomikë anëtarë të bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a. dhe “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, konstatohet si më poshtë:

Operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” sh.a. në plotësim të kriterit për shlyerjen e detyrimeve tatimore ka paraqitur Shtojcën 8 ku ka deklaruar se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar. Gjithashtu ka paraqitur edhe dokumentin Vërtetim (për pagim detyrimesh) me nr. T01028251, datë 02.05.2019, ku deklarohet se: “Rezulton se nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar deri më datën 02.05.2019, ora 08:47:36.

Në lidhje me plotësimin e kriterit për vërtetimin e numrit të punonjësve, operatori ekonomik “Gjoka Konstruksion” sh.a. ka paraqitur dy dokumenta:

- Vërtetimin me nr. T01028239, datë 02.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Mars 2019 duke e përfshirë edhe këtë muaj, ku përsëri rezulton se ky operator ekonomik deri në datën 02.05.2019 nuk ka asnjë detyrim tatimor të papaguar.
- Si edhe po në vijim të përmbushjes së këtij kriteri (kriterit për numrin e punonjësve) operatori ekonomik ka paraqitur edhe vërtetimin me nr. T01083283, datë 20.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Prill 2019 duke e përfshirë edhe këtë muaj, ku rezulton se ky operator ekonomik deri në datën 20.05.2019 ka detyrim tatimor të papaguar vetëm Kontribute gjithsej në shumën 6,624,055 lekë.

III.3.11. Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton se, vërtetimi me nr. T01083283, datë 20.05.2019, që përmban të dhëna në lidhje me numrin e punonjësve deri në muajin Prill 2019, të cilit i është referuar edhe autoriteti kontraktor në arsyen e skualifikimit, në përmbajtje të tij ka të përcaktuar ndër të tjera të dhënat si më poshtë:

Nr.	Periudha tatimore	Numri i kontributeve	Detyrime (kontributet, interesat) Në lekë	Pagesat (kontributet, interesat) Në lekë
1	1904	[...]	6,624,055	0
2	1903	[...]	6,529,129	6,525,129

III.12. Në shqyrtim dhe verifikim të këtij dokumenti në tërësinë e tij, pra që nga pjesa e parë e duke arritur tek pjesa përfundimtare në fund të tabelës ku përcaktohet nëse ka detyrime ose jo, si dhe shuma në lekë për secilin detyrim, konstatohet se, operatori ekonomik ka vetëm detyrime të kontributeve në shumën 6,624,055 lekë, dhe nuk ka asnjë detyrim tjetër në lidhje me kamatvonesat apo gjobat lidhur me kontributet. Këto të dhëna, pra detyrimet në kontribute deri në datën 02.05.2019 ishin të gjitha në vlerën 0 lekë duke dëshmuar se ky operator ekonomik nuk ka detyrime të papaguara deri në datën 02.05.2019, ndërkohë që në datën 20.05.2019, pra brenda të njëjtit muaj, rezulton se ka detyrime në vlerën 6,624,055 lekë, shumë kjo që po të ballafaqohet me faqen e parë të këtij dokumenti, që në krye të tabelës, rezulton vlerë e cila i korrespondon detyrimeve të muajit prill 2019 (muaji i parë në numër rendor të tabelës), shumë kjo e deklaruar edhe në kolonën e fundit të kësaj table. Këto detyrime janë detyrime koherente dhe kanë një afat të caktuar ligjor për t'u paguar e nuk është e detyrueshme të paguhet përpara datës së hapjes së ofertave për një procedurë të caktuar prokurimi, përse kohë që legjislacioni përkatës në fuqi përcakton një afat me diapazon të gjerë, për më tepër, që referuar kriterëve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në dokumentat e tenderit, vërtetimi në lidhje me pagimin e detyrimeve për pagimin e tatimeve e të kontributeve të sigurimeve shoqërore, sipas legjislacionit në fuqi, është përmbushur nëpërmjet dorëzimit të deklaratës përkatëse, për të cilën autoriteti kontraktor në çdo kohë mund të bënte verifikimet e duhura pranë organeve përkatëse.

III.3.13. Sqarojmë se autoriteti kontraktor, sërish ka shfaqur veprime kontradiktore gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të ofertave duke ndërthurur kriteret me njëri tjetrin, e duke shkaktuar paqartësi e konfuzion, pasi, nga njëra anë në lidhje me detyrimet tatimore ankimuesi referuar edhe kërkesave të paraqitura nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit ka paraqitur dokumentacionin e duhur, pra deklaratën Shtojcën 8 për përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ndërkohë që nga ana tjetër, autoriteti kontraktor, për plotësimin e këtij kriteri, që vërtetohet me shtojcën 8 nëpërmjet vetëdeklarimit, i është referuar dokumentave të tjera të dorëzuara nga ankimuesi për përmbushjen e një kriteri tjetër (punësimi mesatar për periudhën Janar 2018 – Mars 2019), e që për më tepër i është referuar dokumentacionit, i cili i referohet një periudhe të pakërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit, pasi është përcaktuar kriteri për periudhën deri në muajin Mars 2019.

Përse më sipër, autoriteti kontraktor, pavarësisht ndërthurjes së dokumentave të paraqitura me kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit, të cilat janë të ndryshme për kritere të ndryshme, duhej të bënte verifikimet e duhura bazuar në të drejtën që i jep legjislacioni në fuqi, me qëllim verifikimin dhe shqyrtimin e saktë të dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga ana e operatorëve ekonomikë.

III.3.14. Edhe në rast se do t'i referoheshim arsyes së skualifikimit të dhënë nga ana e autoritetit kontraktor, në vijim të analizës së bërë më lart, sqarojmë se, në Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 23, datë 9.12.2014 "Për mbledhjen e kontributeve të detyrueshme të sigurimeve shoqërore dhe

shëndetësore”, në pikën 4 “Detyrimi për deklarimin dhe pagesat e kontributeve”, pika 4.3. përcaktohet se:

4.3 Afatet e deklarimit dhe të pagesës së detyrimeve për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore përcaktohen bazuar në statusin e regjistrimit të tatimpaguesve.

a) Deklarojnë dhe paguajnë çdo muaj, brenda datës 20 të muajit pasardhës:

- Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë të regjistruar për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe për tatimin mbi fitimin.

- Tatimpaguesit organizata jofitimprurëse, ente publike kombëtare apo vendore, fondacione të ndryshme, organizata politike apo shoqërore, persona të tjerë juridikë të cilët nuk regjistrohen në QKR, përfaqësi dhe ambasada të huaja, njësi të zbatimit të projekteve të veçanta dhe persona të tjerë të ngjashëm.

b) Deklarojnë dhe paguajnë çdo tre muaj, mbi baza mujore, brenda datës 20 të muajit të parë pas përfundimit të çdo tremujori të vitit kalendarik :

- Tatimpaguesit persona juridikë dhe fizikë të regjistruar për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël.

- Tatimpaguesit persona fizikë të regjistruar si persona të vetëpunësuar në aktivitetet tregtar apo shërbimi ambulant në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave.

- Tatimpaguesit persona fizikë kryefamiljarë që punësojnë individë si punëtorë shtëpie në kuptim të vendimit përkatës të Këshillit të Ministrave[...]

III.3.15. Komisioni i Prokurimit Publik, nga verifikimet e kryera, konstaton se, operatori ekonomik ”Gjoka Konstruktion” sh.a. në datën 02.05.2019 rezulton pa detyrime tatimore, ndërkohë që brenda të njëjtit muaj, pra pas 18 ditësh, në datën 20.05.2019 (referuar dokumentacionit të paraqitur për përmbushjen e kriterit në lidhje me numrin e punonjësve të siguruar, e për më tepër për një periudhë që nuk është kërkuar në dokumentat e tenderit), datë e cila referuar bazës ligjore si më sipër cituar, është afati përfundimtar për pagimin e detyrimeve koherente pra të muajit aktual, siç vërtetohet edhe nga dokumenti nr. T01083283, datë 20.05.2019, të muajit Prill 2019, të cilat paguhen në muajin maj 2019, brenda afateve ligjore të përcaktuara në udhëzimin e Ministrit të Financave, rezulton me detyrime të cilat, siç argumentuam më lart, janë detyrimet aktuale të muajit Prill 2019, pagesa e të cilave bëhet brenda afateve të përcaktuara në legjislacionin përkatës.

III.3.16. Në vijim të këtij interpretimi, Komisioni i Prokurimit Publik, edhe në lidhje me dokumentacionin e paraqitur nga operatori ekonomik ”Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, konstaton se përveç deklaratës mbi përmbushjen e kriterëve të përgjithshme, ka paraqitur edhe dokumentin e datës 12.06.2019, ku deri në datën 11.06.2019 ky operator ekonomik nuk ka asnjë detyrim të paguar.

III.3.17. Në lidhje me dokumentin ”Vërtetim (Për kontributet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore për Tatimpaguesin E-Sig 02/a), me nr. T01154361, datë 13.06.2019”, ku deklarohet lista me numrin e punonjësve për periudhën Shtator 2016 – Maj 2019, i cili është paraqitur në përmbushje të kriterit të përcaktuar në pikën 2.3.2 të kriterëve të veçanta për kualifikim, ashtu siç analizuam edhe më lart për operatorin ekonomik ”Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, ka të bëjë vetëm me detyrimet koherente të muajit maj 2019 pasi vlera si në tabelë ashtu dhe në fund është në të njëjtën shumë në vlerën 8370 lekë gjithsej, detyrime këto të cilat janë detyrime koherente dhe kanë një afat të caktuar ligjor për t’u paguar e nuk është e detyrueshme të paguhen

përpara datës së hapjes së ofertave për një procedurë të caktuar prokurimi, përsa kohë që legjislacioni përkatës në fuqi përcakton një afat me diapazon të gjerë edhe pas datës së hapjes së ofertave, për më tepër, që referuar kritereve të përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në DST vërtetimi në lidhje me listëpagesat është përmbushur duke u dorëzuar deklarata përkatëse, për të cilën autoriteti kontraktor në çdo kohë mund të bënte verifikimet e duhura pranë organeve përkatëse.

Në përfundim të analizës së fakteve përkatëse, Komisioni arrin në konkluzionin se dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues në procedurën e prokurimit, plotëson kërkesat e autoritetit kontraktor dhe konsiderohet i vlefshëm.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues qëndron.

III.4. Në lidhje me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues për operatorin ekonomik të kualifikuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik ankimues ka ofertuar me vlerë më të ulët kundrejt operatorit për të cilin paraqet pretendime për kualifikim, duke mos pasur një interes të ligjshëm të ankohet për operatorët ekonomikë të renditur me vlerë ekonomike më të lartë se vlera e ofertës së tij ekonomike.

Rrjedhimisht, pretendimet e operatorit ekonomik ankimues në lidhje me operatorin ekonomik të kualifikuar nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruktion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj, për procedurën e prokurimit “*Procedurë e Hapur*”, me nr. REF-19520-04-24-2019, me objekt: “*Ndërtim Rruga Kardhiq – Delvinë, Loti 7*”, me fond limit 2.332.573.946 lekë (pa TVSH), zhvilluar në datën 17.06.2019, nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së për skualifikimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruktion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj. dhe të korrigjojë shkeljet e konstatuara si më sipër, duke e kualifikuar këtë operator ekonomik.

3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Gjoka Konstruksion” sh.a. & “Cobial” sh.p.k. & “JV “GR Albania” sh.p.k. & “Geoportal” d.o.o. degë e shoqërisë së huaj.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1230 Protokolli

Datë 09.07.2019

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Evis Shurdha